



Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

të Komunës Ana e Malit/Shkodër



Korrik 2011

Hartimi i këtij plani u mundësua nga një financim i Helvetas Swiss Intercooperation në kuadër të Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), në periudhën **Mars-Korrik 2011**

Ekipi që përgatiti planin e Menaxhimit të Mbetjeve përbëhej nga **Mihallaq Qirjo, Eduart Cani, Rezart Kapedani dhe Genta Hoxha të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC), Shqipëri** në bashkëpunim me stafin e komunës **Ana e Malit** të bashkërenduar nga **Z. Valentin Gocaj**.

Përgatitja e këtij plani është mbështetur institucionalisht nga drejtuesit e Komunës Ana e Malit për periudhën Mars – Korrik 2011.

Falenderojmë banorët e Komunës Ana e Malit për pjesëmarrjen aktive dhe kontributin në përgatitjen e Planit dhe në veçanti: Abdullah Poti, Anis Kasemi, Arlinda Malja, Artur Frroku, Atlije Teluka, Bardhyl Isufi, Bashkim Vela, Brahim Shega, Dhurata Velaj, Dritan Malja, Elvis Gocaj, Fatmir Prroni, Gogo Pemaj, Gzim Beqiri, Haxhi Shmitra, Kujtim Lekaj, Liza Topalli, Muhamet Molla, Myrvete Teluka, Ramiz Sherbela, Saimira Dyli, Shemsi Kroni, Shpresa Prroni, Sytki Hoxha, Valdete Lekaj, Vjollca Sadeli, Vincenc Gocaj etj.

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	3
1. Hyrje/Konsiderata të përgjithshme	4
1.1 Komuna Ana e Malit	5
1.2 Analiza e SWOT	11
1.3 Qëllimi i planit.....	12
1.4 Kuadri ligjor kombëtar ku mbështetet ky plan.....	12
2. Vlerësimi i gjendjes së mbetjeve.....	14
2.1 Rrymat e mbetjeve.....	14
2.2 Sasia e mbetjeve të prodhuara	15
2.3 Menaxhimi i mbetjeve	16
2.4 Kushtet specifike dhe ndryshimet sezonale.....	17
2.5 Raste të jashtëzakonshme që prodhojnë mbetje.....	17
3. Skema e Menaxhimit të Mbetjeve	19
3.1 Konsiderata paraprake	19
3.2 Ndarja në faza.....	19
3.3 Faza I	20
3.4 Parimi "ndotësi paguan"	24
3.5 Faza II	25
3.6 Faza III	27
3.7 Ri-Investime	28
4. Plani i ndërgjegjësimit dhe edukimit të komunitetit	29
4.1 Objektivat e PNEK	29
4.2 Vlerësimi i gjendjes dhe mundësive aktuale	30
4.3 Mjetet e mundshme të komunikimit dhe informimit.....	30
4.4 Rolet dhe përgjegjësitë në pnek.....	33
4.5 Indikatorët e suksesit.....	35
5. Shtojcat	37

1. HYRJE/KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Komunën Ana e Malit vjen si kërkesë e banorëve të kësaj komune për të përmirësuar gjendjen e mjedisit dhe shëndetit në këtë komunë. Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen e plotë nga administrata vendore, e cila ka bërë përpjekje për të minimizuar ndotjen që është grumbulluar në vite në territorin e komunës, por që tashmë është kthyer në një burim i rrezikshëm ndotje.

Ky plan pritet të gjejë mbështetjen e plotë të të gjithë banorëve dhe aktorëve vendorë si dhe do të mundësojë zgjidhjen më të përshtatshme për të larguar maksimalisht ndotjen në përrrenjtë dhe lumin Buna si dhe ruajtur shëndetin e banorëve nga ndotja.

Plani është hartuar në një proces gjithëpërfshirje dhe mirëkuptimi me të gjithë banorët dhe aktorët. Ai do të gjejë mbështetjen e plotë nga këshilli i komunës dhe do të mund të bëhet menjëherë i zbatueshëm në sajë të mbështetjes financiare të dhënë nga programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor dldp, i cili do të bëjë të mundur ngritjen e skemës së menaxhimit.

Futja për herë të parë të normave të menaxhimit të mbetjeve, do të kërkojë një angazhim njerëzor dhe financiar si dhe një mbështetje shumë të qëndrueshme nga pagesit e tarifës së mbetjeve, të cilët janë familjarët, biznesi dhe institucionet.

Ky plan është hartuar në dy faza të qarta dhe një fazë të mëvonshme, e cila do të kërkojë fuqizimin dhe ngritjen e skemës në nivelet më bashkëkohore të kërkuar nga politikat kombëtare.

Në fazën e parë, plani do të përqipet të ndalojë grumbullimin e mëtejshëm të mbetjeve në territorin e komunës, duke mundësuar largimin në destinacionin përfundimtar. Në këtë fazë vetëm fshatrat më numër popullsie më të madhe dhe të vendosura në rrugët kryesore të komunës do të përfitojnë mbulim të plotë. Kjo skemë, e cila trajtohet më hollësisht në kapitujt përkatës, është mbështetur nga banorët dhe nga aktorët e tjerë të konsultuar, si më e përshtatshme. Gjithashtu, kjo fazë do të mundësojë vendosjen e plotë të skemës së menaxhimit nga ana njerëzore dhe ekonomike, duke mundësuar kalimin më të shpejtë në fazat e tjera. Megjithatë, banorët dhe bizneset do të inkurajohen që të sjellin pranë zonave të grumbullimit, mbetjet që ata prodhojnë.

Në fazën e dytë do të mundësohet një mbulim i plotë i komunës me shërbim, duke mundësuar largimin e plotë të mbetjeve nga komuna.

Në fazën e tretë, do të shikohet mundësia e projekteve të rehabilitimit, të cilat janë shumë urgjente dhe të domosdoshme. Pastrimi i përrrenjve shumë të ndotur si dhe zonave të tjera ku ka grumbullim mbetjesh, do të shmangë burimin e ndotjes për tokën, ujin dhe ajrin dhe do të largojë rrezikun për shëndetin njerëzor. Bashkëlidhur këtij plani jepen dhe fisha projektesh, të cilat japin një ide të përgjithshme për ndërhyrjen e kërkuar.

Për të bërë të mundur zbatimin e këtij plani, stafi i Komunës do të ndajë detyrat përkatëse, në mënyrë që të rritet komunikimi me financuesit e mundshëm dhe veçanërisht tërheqja e mbështetjes nga vetë banorët dhe bizneset vendas.


Plani do të mbështetet veçanërisht në interesin shumë të madh të banorëve dhe të rinjve të komunës për të organizuar fushata ndërgjegjësimi dhe pastrimi, drejt arritjes së qëllimeve të planit.

1.1 KOMUNA ANA E MALIT

1.1.1 Pozicioni gjeografik

Komuna Ana e Malit ndodhet 6 km në Jug-Perëndim të qytetit të Shkodrës me një shtrirje 44 km². Ajo kufizohet në Veri dhe Veri-Lindje me qytetin e Shkodrës, në Perëndim me Malin e Zi, në Jug dhe Jug-Lindje me lumin Buna në gjatësi 17 km si dhe në Lindje me Komunën Bërdicë. Është komunë kufitare me Malin e Zi dhe portë hyrëse nëpërmjet pikës doganore të përbashkët Mali i Zi- Shqipëri, pranë fshatit Muriqan.

Komuna ka gjithsej 10 fshatra, (Oblikë, Bobot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar) prej të cilëve vetëm 6 janë të banuar, ndërkohë që katër fshatrat malorë (Vidhgar, Dramosh, Bobot dhe Vallas) janë braktisur për shkak të pamundësisë për të siguruar një jetesë të përshtatshme.



Harta 1. Pozicioni gjeografik i komunës



Harta 2. Relievi i komunës dhe pasuritë natyrore

1.1.2 Popullsia

Komuna Ana e Malit ka gjithsej të regjistruar 5 854 banorë, për vitin 2011. Kjo popullsi është e vendosur në 6 fshatra të komunës, kryesisht në fshatrat më të mëdhenj Oblikë (qendra e komunës) dhe Muriqan.

Është për t'u theksuar se për shkak të kushteve ekonomike, popullsia e fshatrave malore është zhvendosur në pjesën më fushore duke formuar dhe fshatin Alimetaj.

Ashtu si kudo, edhe Komuna Ana e Malit është prekur nga fenomeni i emigracionit. Një numër i konsiderueshëm i banorëve (rreth 870 banorë) dhe pse janë të regjistruar në Komunë, jetojnë e punojnë jashtë vendit. Emigracioni ka prekur më shumë fshatin Obot (rreth 380 banorë), i cili gjenden në pjesën më fushore të komunës, pranë lumit Buna. Për këtë arsye, ky fshat është më pak i populluar, por me një potencial shumë të rëndësishëm për komunë, për shkak se shtrihet në pjesën më vitale të saj.

Numri i familjeve të regjistruara në komunë është 1573, prej të cilave vetëm 14 nuk janë me banim të përhershëm në fshat. Një familje normale e komunës Ana e Malit, është e përbërë nga 3-4 persona e shpërndarë kjo sipas fshatrave specifike.

Tabela 1. Popullsia e komunës (Prill 2011)

		Komuna	Emri i fshatit					
			Oblikë	Muriqan	Obot	Velinaj	Alimetaj	Shtuf
1	Numri i banorëve	5854	2643	1219	688	347	941	196
2	Numri i regjistruar i familjeve (viti 2011)	1573	750	332	210	113	125	43

1.1.3 Infrastruktura dhe ekonomia

Komuna Ana e Malit është një komunë e vogël dhe, për rrjedhojë, dhe veprimtaritë e ndryshme të biznesit apo institucionale janë në përputhje me vetë madhësinë e komunës dhe mundësitë që ka për zhvillimin e biznesit. Komuna shquhet dhe ka traditë në kultivimin e perimeve duke u bërë bazë për furnizimin e qytetit të Shkodrës. Kështu, veprimtaria e serave në komunë është shumë e zgjeruar dhe përbën një problematikë shumë të rëndësishme, e cila trajtohet nga plani i menaxhimit. Gjithashtu, në kodrat e komunës, megjithëse me një reduktim të ndjeshëm, është e zhvilluar pemtaria, ku një vend të veçantë zë kultivimi i ullirit, me rreth 60 000 rrënjë.

Komuna është në nyjen e rëndësishme që lidh Shqipërinë me Malin e Zi e më tej me Kroacinë, nga ku kalojnë një numër shumë i madh udhëtarësh. Megjithatë, në komunë nuk ka asnjë biznes turistik apo njësi shërbimi turistike, përveç disa bareve në pikën doganore. Kjo mundësi turistike dhe të ardhurash, mund të shikohet më përparësi në të ardhmen, në mënyrë që udhëtarët të mund të nxitin të ndalojnë në komunë, për të vizituar lumin Buna apo për të provuar shijet e kuzhinës së zonës.

Tabela 2. Bizneset dhe institucionet që ushtrojnë veprimtarinë në Komunën Ana e malit

		Komuna	Emri i fshatit					
			Oblikë	Muriqan	Obot	Velinaj	Alimetaj	Shtuf
8	Numri i bizneseve të shërbimeve	42	23	15	1	1	2	0
10	Numri i aktiviteteve të tjera (industriale) prodhuese-përpunuese	6	2	2	1	1	0	0
	Numri i përgjithshëm i bizneseve	48	25	17	2	2	2	0
11	Numri i qendrave	6	1	1	1	1	1	1

	shëndetësore							
12	Numri i shkollave (9-vjeçare+mesme)	6	3	1	1	0	1	0
13	Institucione parashkollore	4	1	1	1	0	1	0
14	Numri i institucioneve të tjera (fetare, etj)	8	3	1	1	1	1	1
	Numri i përgjithshëm i institucioneve	24	8	4	4	2	4	2

Tabela 3. Infrastruktura rrugore

Lloji i rrugëve	Njësia	Gjithsej	Asfalt	Kalldrëm	Pashtruar
Të brendshme	km	26	3	18	5
Rurale	km	14	14	0	0

Tabela 4. Ujësjetës

	Gjithsej	Jashtë funksionit
Ekzistues	5	4

Në komunë nuk ka shërbime të medias televizive, radios apo të shtypur. Shërbimet e vetme të komunikimit janë ato postare dhe telefonike. Megjithatë, në komunë funksionon shërbimi i internetit dhe ky është shumë i përdorur nga banorët.

Niveli i punësimit është në nivele të ulëta, me rreth 238 të punësuar, përkatësisht, 123 në atë privat dhe 115 në atë shtetëror, ndërkohë që komuna i shërben me ndihmë sociale rreth 115 dhe me asistencë 156 personave

1.1.4 Pasuritë natyrore

Terreni i komunës Ana e Malit është fushor, kodrinor dhe malor, duke mundësuar kështu një pasuri të madhe natyrore. Në territorin e komunës gjenden pasuri pyjore, ujore dhe tokësore, të cilat përbëjnë një vlerë shumë të rëndësishme për banorët e zonës dhe të të gjithë rajonit të Shkodrës.

Pasuria më e madhe natyrore e kësaj zone është vetë lumi Buna¹, i cili kufizon komunën në pjesën Jugore me një gjatësi prej 17 km. Ky lum është me vlera të mëdha natyrore dhe turistike për komunën, si dhe përbën burimin më vital të pasurimit të tokës pjellore të komunës². Nga Ana e Malit derdhen në Bunë një numër i madh përrenjsh, më i gjati i të cilëve është Përroi i Millës me gjatësi 25 km dhe pas tij Përroi i Megjureshit me gjatësi 21,6 km.

Komuna ka një strukturë të tokës prej 4 180 ha, e cila është e ndarë në: Tokë bujqësore (arë), 2579 ha; Truall e jo-prodhuese, 913 ha; Livadh, pyje e kullota, 688 ha.

1.1.5 Menaxhimi i burimeve natyrore

Komuna Ana e Malit, nuk ka një strategji zhvillimi të territorit apo të pasurive natyrore. Mungesa e një dokumenti të tillë nuk ka mundësuar integrimin e shumë çështjeve të zhvillimit në komunë si dhe për pasojë dhe të menaxhimit të pasurive natyrore.

Të gjitha pasuritë natyrore të komunës, të përmendura më sipër, janë të prekura nga zhvillimi i komunës, sidomos nga hedhja e mbetjeve nëpër tributarët që përshkojnë komunën si dhe në tokën bujqësore dhe atë pyjore.

Megjithatë, komuna në prioritet e saj ka pikërisht menaxhimin e burimeve natyrore, dhe përmirësimin e shërbimit në komunë, në dobi të ruajtjes së pasurive natyrore. Ndër këto prioritet, më kryesorët janë:

1. Sistemimi i lumit Buna dhe përrenjve malorë që dëmtojnë tokën bujqësore;
2. Menaxhimi i mbetjeve urbane;
3. Sistemimi i ujërave të zeza në qendër të fshatit Oblikë, blloku i pallateve; dhe
4. Pastrimi dhe sistemimi i rrjetit të kullimit.

Ashtu si dhe parashtrohet në prioritetet e komunës, nevoja për sistemin e përrenjve të komunës dhe pastrimi i sasive të mëdha të mbetjeve në to është një nevojë urgjente. Këto përrenj, janë kthyer në ndotës të vazhdueshëm të lumit Buna dhe për rrjedhojë të zonës së poshtme të saj, deri në detin Adriatik.

Shpallja e lumit Buna dhe territoreve përreth tij si zonë e mbrojtur, veç detyrimeve ligjore, mundëson dhe një bazë të fuqishme për hartimin e planeve të menaxhimit dhe thithjen e investimeve në mbrojtje të pasurive natyrore, në të cilat shtrihet komuna.

¹ Lumi ka gjatësi 44 km dhe rrjedh përgjatë fushave të Bregut të Bunës ku përfshihen fusha e Anamalit në të djathtë të lumit dhe fusha e Trushit bashkë me fushën e Velipojës në të majtë.
Prurja mesatare vjetore e Bunës arrin 670 m³/sek, kjo e bën këtë lum të jetë një nga lumenjtë me prurjen më të madhe në Mesdheun verior. Me këtë lum lidhet liqeni me detin, për këtë disa peshq vijnë nga deti duke ngjitur lumin hyjnë në liqen për të vëndosur vezët, të tillë si: qefulli, kubla, blini etj.
Gjithashtu, Buna, së bashku me ujërat e saj, përfaqëson një nga sipërfaqet më të pasura me shpendë në rajon. Grykëderdhja e Bunës, Rezervati i Velipojës, Kënetat e Domnit, Viluni, Liqeni i Shasit, kriporja e Ulqinit, sipërfaqja kënetore e Shtojit të poshtëm të Ulqinit janë plot me shpendë veçanërisht në dimër. Avifaunat e këtyre sipërfaqeve komunikojnë me njera-tjetrën, por edhe me Liqenin e Shkodrës, lagunën e Kunës e më gjerë. Këto sipërfaqe përfshihen në njërin prej tre rrugëve të migrimit të shpendëve të Evropës.

² Me VKM, Nr. 682, datë 2.11.2005 Lumi Buna dhe të territoret ligatimore përreth tij janë shpallur "peisazh ujor/tokësor i mbrojtur" dhe për vlerat e veçanta ligatimore, ajo është tashme pjesë e listës botërore si zonë Ramsar.

Kësisoj, hartimi i një plani zhvillimi për komunën do të mundësonte një kuptim më të drejtë të nevojave, objektivave dhe aktiviteteve të nevojshme për të administruar më mirë territorin dhe pasuritë natyrore të kësaj komune.

Mbrojtja e lumit Buna, duke ndërthurur element të zhvillimit bashkëkohor, siç janë korridoret e shëtitjes dhe sidomos ato të vrojtimit të zogjve, do të mundësonte një interes më të madh të vizitorëve në këtë zonë dhe për rrjedhojë një nxitje të mëtejshme për zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre pasurive.

1.1.6 Problematika e menaxhimit të mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e qeverisjes vendore. Aktualisht zbatimi i këtij funksioni konsiston në vetëm punën e dy punonjësve, të cilët me mjete të tyre të thjeshta largojnë mbetjet që mbledhen pranë institucioneve, bizneseve ose grupe familjesh, pa patur skemë të menaxhimit të mbetjeve.

Praktikisht, komuna nuk ka patur deri më tani një program të mirëfilltë studimi për menaxhimin e mbetjeve urbane. Kjo ka bërë që mbetjet të grumbullohet sipas mundësisë dhe ndërgjegjjes së vetë banorëve nëpër vende të përcaktuara dhe kryesisht përgjatë përrenjve. Si pasojë e kësaj gjendje e mbetjeve në komunë është shumë kritike, sidomos në fshatin Oblikë, ku dhe depozitimi i mbetjeve bëhet direkt në përroin e fshatit, i cili është i tejmbushur me mbetje. Kjo situatë është kthyer në një burim të madh ndotje natyrore dhe sidomos shëndetësore.

Ky plan, është ngritur pikërisht në përgjigje të kësaj problematike dhe do të vendosë për herë të parë modelin e menaxhimit dhe të gjitha çështjet infrastrukturore, njerëzore dhe ekonomike që lidhen me të.

1.1.7 Gjetje paraprake të vlefshme për hartimin e planit dhe menaxhimin e mbetjeve

Gjatë procesit të hartimit të këtij plani, u organizuan disa takime me banorët dhe grupet e interesit (prill – maj 2011) nga ku rezultuan disa gjetje, shumë të vlefshme për hartimin e planit, por dhe për zbatimin e tij:

- Interes shumë i lartë i banorëve për të mbështetur skemën e pastrimit dhe përmirësimit të gjendjes mjedisore në komunë;
- Banorët e kuptojnë rrezikun e madh që vjen nga ndotja dhe që në disa zona të komunës nevoja për ndërhyrje është shumë urgjente;
- Biznesi i komunës e mbështet skemën e menaxhimit dhe është gati të paguajë tarifën e menaxhimit;
- Të rinjtë e shkollave dhe vetë institucionet shkollore janë shumë aktivë dhe të gatshëm të mbështesin në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe në fushata pastrimi;
- Banorët pranojnë se sistemi i menaxhimit të mbetjeve duhet mbështetur me tarifën përkatëse dhe janë të gatshëm ta paguajnë atë;

- Dërgimi i mbetjeve në fushën e Bushatit është përkrahur 100% nga banorët, duke mundësuar kështu largimin e ndotjes që do të shkactohej nga ndërtimi i një fushe depozitimi jo-sanitare në komunë;
- Mbrojtja e lumit Buna përbën një shqetësim shumë të madh të banorëve;
- Niveli i pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe sidomos roli i grave është shumë i kënaqshëm dhe përbën një premisë shumë të mirë për zbatimin e planit;
- Nga banorët është paraqitur dhe nevoja për të filluar procesin e ndarjes së mbetjeve në nivel familje dhe për këtë kërkojnë nga komuna vendosjen e një sistemi që i grumbullon të ndara mbetjet;
- Në komunë nuk ka grupe të OJF-ve, të cilat të mundësojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe organizimin e fushatave të ndryshme në mbrojtje të natyrës dhe shëndetit;
- Në komunë ka një numër shumë të madh familjesh dhe individësh të cilët marrin ndihmë sociale, duke bërë të pashmangshëm mbështetjen financiare të komunës për skemën e menaxhimit.

1.2 ANALIZA E SWOT

Anët e forta	Anët e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje e gjerë nga banorët, biznesi dhe institucionet; • Kuptimi i drejtë dhe i qartë i gjendjes mjedisore në komunë; • Njohja e vlera të pasurive natyrore dhe potencialit që ato përfaqësojnë; • Gjendja në një zonë të rëndësishme të kalimit të vizitorëve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e një plani të përgjithshëm zhvillimi; • Niveli i ulët i zhvillimit të komunës; • Niveli i ulët i kualifikimit të stafit të komunës lidhur me këtë sektor; • Mungesa e grupeve qytetare aktive në komunë; • Mungesa e një ekipi që mundëson gjetjen e fondeve dhe mbështetjes nga burime të ndryshme.
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja nga pushteti vendor dhe institucionet; • Mbështetje e gjerë nga donatorët e ndryshëm; • Vendndodhja në një zonë të mbrojtur dhe me vlera të mëdha natyrore; • Prioritet i lartë i zonës për zhvillim. 	<ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i ulët i komunës; • Pamundësia e banorëve për të paguar tarifat; • Vazhdimi i hedhjes së mbetjeve jashtë pikave të grumbullimit; • Pamundësia për të shtrirë skemën në të gjithë komunën; • Pamundësia për të paguar tarifën në fushën e mbetjeve në Bushat për shkak të ndonjë rritje të tarifës; • Ndryshimet strukturore dhe të politikave vendore; • Pamundësia për të siguruar përfshirje në kohë të gjatë apo të përhershme të të gjithë aktorëve.

1.3 QËLLIMI I PLANIT

Objektivi i përgjithshëm

Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe mjedisit në komunën Ana e Malit

Objektivat specifike

- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për komunën
- Ngritja dhe forcimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të banorëve të zonës në zbatimin e një plani menaxhimi eficient.

1.4 KUADRI LIGJOR KOMBËTAR KU MBËSHTETET KY PLAN

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Komunën bazohet dhe është ndërtuar në përputhje me qëllimet dhe synimet kombëtare për menaxhimin e mbetjeve si dhe harmonizim e përpjekjeve rajonale në menaxhimin e mjedisit në përgjithësi.

Ky dokument është në linjë me parimet dhe rregullat e përcaktuara nga draft Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar³ përkatës, si dhe në normat dhe kriteret e vendosura nga zona e menaxhimit të mbetjeve nr.4 e cila përfshin Qarkun e Shkodrës.

Strategjia përcakton rolet dhe përgjegjësitë e secilit aktor në menaxhimin e mbetjeve. Veçanërisht ajo përcakton për NjQV-të si mëposhtë:

Qeverisja vendore ka për detyrë të organizojë heqjen e mbetjeve dhe të kontrakttojë kompanitë që pastrojnë qytetet (neni 20 i ligjit nr. 8094); të hartojë dhe miratojë rregulloret specifike territoriale për çdo metodë të menaxhimit të mbetjeve duke ndjekur prototipet e miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë (neni 11 i ligjit nr. 9010).

Bashkitë dhe komunat vendosin tarifatat për heqjen e mbetjeve në territoret nën juridiksionin e tyre dhe autorizojnë persona të caktuar për t'i mbledhur ato (nenet 31 & 34 të ligjit nr. 8094);

Ligji nr.8652, dt.31.07.2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisë vendore", neni 10, njuh veprimtaritë për administrimin e mbetjeve (mbledhjen, transportin, trajtimin, dhe asgjësimin) në nivelin lokal si funksione të veta në zonën e investimeve dhe shërbimeve publike.

Autoritetet e qeverisjes vendore janë të përgjegjshme për të përcaktuar mbledhjen e mbetjeve dhe përpunimin e tyre në vende të caktuara, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit; për organizimin e vend-depozitimit për mbetjet dhe substancat e rrezikshme; për

³ Draft Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve janë përgatitur nga projekti CARDS 2006 - INPAEL dhe janë paraqitur për miratim pranë Qeverisë Shqiptare në Muajin Prill 2011.

mbetjet urbane dhe trajtimin e mbetjeve të impianteve të ujit. Bashkitë kanë sektorë të veçantë për pastrimin e qytetit dhe menaxhimin e mbetjeve.

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Qarkut/Bashkisë përcakton vendin e grumbullimit (një sipërfaqe të barabartë ose më pak se 0,5 ha) për të gjitha llojet e mbetjeve (teknologjikë/urbane/inerte) në territorin e juridiksionit të tyre (nenet 9, 20 & 34 të ligjit nr. 8405).

Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoriteti kontraktues për koncesionet e aktiviteteve ekonomike nën juridiksionin e vet, gjithashtu edhe për projektet koncesionare mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Inspektoratet bashkiake bashkëpunojnë me Inspektoratin e Mjedisit dhe në raste të veçanta me inspektoratet e tjera, për të kryer inspektime mbi aktivitetet të lidhura me mbetjet në territoret nën juridiksionin e tyre.

Gjithashtu ajo përcakton Politikën për Administrimin e Integruar të Mbetjeve, e cila shprehet se që të arrihet një ndryshim efektiv dhe një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme mbi problemin e administrimit të mbetjeve në Shqipëri, puna duhet të përqendrohet në katër shtylla kryesore siç janë:

Planifikimi, Edukimi, Financimi dhe Legjislacioni

Këto shtylla, të cilat janë shumë të rëndësishme për zgjidhjen afatgjatë të degës së administrimit të mbetjeve në nivel kombëtar, por gjithashtu përbëjnë bazën e qëndrueshmërisë në nivel vendor.

Ky plan menaxhimi do të fokusohet pikërisht në ndryshimin e qëndrimeve dhe praktikave aktuale të individëve, subjekteve të biznesit dhe institucioneve. Ky proces, vërtetë do të marrë shumë kohë, fuqi dhe investime, por do të mundësojë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë.

2. VLERËSIMI I GJENDJES SË MBETJEVE

2.1 RRYMAT E MBETJEVE

Në komunë gjenerohen ajo tipologji mbetjesh, të cilat janë të zakonshme në të gjithë vendin. Kjo listë e mbetjeve përmban:

- a) mbetje të letrës;
- b) plastikës;
- c) qelqit;
- d) aluminit; dhe veçanërisht ato
- e) ushqimore.

si dhe

- f) Mbetjet bujqësore dhe blegtorale

Si një zonë rurale, ka një prodhim të konsiderueshëm të mbeturinave bujqësore dhe të kafshëve, por këto nuk janë çështje e menaxhimit të këtij plani pasi përdoren nga vetë fshatarët për plehrimin e tokës. E rëndësishme për këtë kategori mbetjesh është që të rritet ndërgjegjësimi i banorëve për të mos lejuar depozitimin e tyre në mjedise publike dhe në mjedise të ndjeshme. Për më tepër, ulja e përdorimit të kimikateve dhe pesticideve është pjesë e diskutimit me banorët, për të shkuar drejt produkteve të pastra dhe mbrojtjes së tokës e burimeve nëntokësore.

- g) Mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishja

Aktiviteti ndërtues dhe ai rikonstruksionit nuk është i konsiderueshëm, ndaj dhe mbetjet inerte të prodhura nuk përbën një çështje për trajtim të veçuar. Me rëndësi është që banorëve dhe biznesit t'u bëhet e ditur se nuk mund të depozitojnë mbetjet inerte në kazanë dhe se në rastet kur ndodh diçka e tillë, kjo përbën shkelje administrative. Këto mbetje mund të trajtohen sipas rastit me leje të komunës, në mbushjen e rrugëve për shtrim apo nevoja të tjera.

Sasia specifike e mbetjeve, për secilën rrymë nuk është e llogaritur dhe pse ekipi ka bërë përpjekje për të kuptuar me anë të matricave bashkëlidhur këtij plani, përgjigja nga të pyeturit (banorë dhe biznes) nuk ka qenë e besueshme. Për këtë një fazë tjetër anketimi, pas zbatimit të investimit do të ishte shumë e vlefshme për të kuptuar sasi të specifike për çdo rrymë mbetjesh.

Në këto kushte është bërë një mesatarizim sipas kriterëve të përcaktuara dhe sipas standardeve kombëtare dhe ato të rajonit. Një analizë më e plotë mbi llogaritjen e sasive dhe burimet të mbetjeve, vijon më poshtë. Këto të dhëna dhe përlllogaritje do të ndihmojnë në përcaktimin e të gjitha hallkave të planit dhe sidomos të përcaktimit të kostove dhe tarifave që do të vendosen.

2.2 SASIA E MBETJEVE TË PRODHUARA

Për përllogaritjen e sasisë së mbetjeve të prodhuara një nga faktorët më të rëndësishëm ishte sasia ditore e prodhimit të mbetjeve për banor. Për llogaritjen e kësaj vlere u morrën parasysh vlerat e llogaritura në planin e menaxhimit të mbetjeve për zonën e Shkodrës ku kjo komunë është përfshirë në zonën 4 (katër). Vlera e këtij studimi rezulton të jetë 0.6 kg/person/ditë. Megjithatë, pas disa vrojtimit në terren duhet theksuar se kjo vlerë përfaqëson vlerën maksimale të llogaritur pasi në realitet këto vlera janë më të ulta për shkak të disa faktorëve të cilët do të ravigjzohen më mirë gjatë zbatimit të këtij plani

Deri tani për shkak të mungesës së një plani të menaxhimit të mbetjeve nuk ka pasur njohuri mbi sasinë e mbetjeve të prodhuara dhe menaxhimit të tyre. Më poshtë do të paraqesim disa aspekte të rrymës së mbetjeve në komunën Ana e Malit:

2.2.1 Burimi i mbetjeve

Burimet e mbetjeve për komunën Ana e Malit janë të shumta për shkak se dhe ka disa lloje të ndryshme aktivitetesh mbetje-prodhues që zhvillohen në këtë komunë. Më poshtë po japim burimet kryesore të mbetjeve duke paraqitur dhe rëndësinë e tyre:

2.2.1.1 Banorët

Pa dyshim janë prodhuesit më të mëdhenj të mbetjeve gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm. Vlera maksimale potenciale e përllogaritur e prodhimit të mbetjeve për komunën Ana e Malit është rreth 3,5 ton mbetje në ditë apo rreth 1280 ton mbetje brenda një viti. Duke qenë se kjo vlerë është llogaritur me numrin teorik të banorëve, është llogaritur më pas dhe një vlerë që është më afër realitetit për gjenerimin të gjithë komunën, që është rreth 3 ton mbetje në ditë apo 1090 ton mbetje në vit, e cila merr parasysh dhe migrimin dhe emigrimin e banorëve. Së bashku, tre fshatrat kryesorë të komunës Ana e Malit prodhojnë 2.3 ton mbetje në ditë apo 846 ton mbetje në vit. Edhe këto vlera janë pak më të larta se realiteti si për shkak të koeficientit (0.6 kg/person/ditë) ashtu si dhe për shkak të potencialit real ekonomik të zonës.

2.2.1.2 Institucionet

Për përllogaritjen e prodhimit të mbetjeve nga institucionet është marrë në koeficient prej 8 kg/institucion/ditë. Komuna Ana e Malit ka 24 institucione dhe sasia vjetore e prodhimit të mbetjeve për institucionet është llogaritur në 70 ton në vit.

Shënim: Megjithatë duhet theksuar se në këtë përllogaritje është futur si vlerë e llogaritur dhe sasia e mbetjeve që prodhohet nga gjashtë qendrat shëndetësore që ndodhen në gjashtë fshatrat kryesorë të komunës. Në fakt këto qendra shëndetësore një pjesë të mbetjeve të tyre e kanë të papërshtatshme për t'u futur në mbetjet urbane të përgjithshme. Mënyra dhe trajtimi i këtyre mbetjeve speciale del jashtë qëllimit të këtij plani dhe me shumë gjasa eliminimi i tyre duhet futur në kuadrin e një plani më të përgjithshëm në rang rajoni.

Duhet theksuar se për tre fshatrat kryesorë niveli i gjenerimit të mbetjeve nuk është më i lartë se 46 ton në vit.

2.2.1.3 Bizneset

Bazuar në të njëjtën metodologji koeficienti i prodhimit të mbetjeve nga bizneset është marrë 10 kg për biznes në ditë. Kjo vlerë është mesatare pasi bizneset variojnë si nga madhësia e tyre ashtu dhe nga lloji i biznesit që ato kanë. Sidoqoftë mungesa e biznesit të madh bën që kjo shifër të mos jetë shumë larg realitetit. Biznesi në komunën Ana e Malit prodhon sipas përlogaritjeve 175 ton mbetje në ditë, ndërkohë që tre fshatrat kryesorë prodhojnë 160 ton në ditë (siç shihet pjesa më e madhe e bizneseve është e përqendruar në këto tre fshatra). Nga analiza paraprake ka mundësi që mbetjet e prodhuara nga bizneset të jenë më të vogla, duke qenë se një pjesë e madhe e bizneseve prodhojnë mbetje organike të cilat mund të përpunohen edhe *in situ* pa pasur nevojë të kalojnë në rrugën e trajtimit të mbetjeve të tjera urbane.

2.3 MENAXHIMI I MBETJEVE

2.3.1 Situata aktuale

Duke qenë se nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve nuk ka dhe menaxhim të saktë të tyre dhe situata është deri diku kaotike. Megjithatë janë bërë disa vëzhgime të situatës aktuale për të kuptuar më mirë situatën dhe mentalitetin e banorëve si dhe vendet të cilat mund të kenë nevojë në të ardhmen për rehabilitim. Shpjegimet për menaxhimin aktual janë dhënë sipas kategorive të prodhuesve të mbetjeve:

2.3.1.1 Banorët

Banorët deri tani nuk kanë pasur një vend të përcaktuar për grumbullimin e mbetjeve. Kjo do të thotë se në përgjithësi se mbetjet janë hedhur në zona afër shtëpive, buzë rrugës apo më keq akoma në përrenjtë e komunës. Deri tani situata më problematike është në fshatin Oblikë ku përqendrimi më i lartë i banorëve është në disa banesa shumëkatëshe që ndodhen shumë afër përroit ku dhe hedhin dhe pjesën më të madhe të mbetjeve të tyre. Kjo ka bërë që përroi të jetë shumë i ndotur dhe të krijojë probleme si vatër infeksioni dhe ndotjesh për banorët e zonës. Probleme ka dhe fshati Obot i cili ndosht shumë afër lumit Buna si dhe duke qenë se është në kuota shumë të ulëta është i rrezikuar dhe nga përmytjet. Shpesh mbetjet e prodhuara në këtë fshat kalojnë në rrjedhën e lumit Buna duke shkaktuar ndotje në komnatat e poshtme deri në derdhjen në det.

2.3.1.2 Institucionet

Prodhuesit më të mëdhenj të mbetjeve në institucionet janë shkollat. Pothuajse në të gjithë shkollat ndodhen pika shitje me pakicë të cilat shesin artikuj të ndryshëm ku në shumicën e rasteve ambalazhimet e tyre përfundojnë si mbetje në oborret e shkollave apo jashtë rrethimit të tyre. Institucionet e tjera prodhojnë më pak mbetje ose prodhojnë mbetje të një lloji tjetër (shih shënimin mbi qendrat shëndetësore)

2.3.1.3 Bizneset

Bizneset deri diku janë kategoria më e disiplinuar për menaxhimin aktual të mbetjeve. Për shkak dhe të fuqisë më të madhe financiare që kanë si dhe të kërkesës për ruajtje të imazhit, ato edhe para funksionimit të planit të menaxhimit kanë paguar një tarifë që të hiqnin mbetjet nga mjediset e tyre (megjithëse këto mbetje nuk është se janë përpunuar në mënyrën e duhur më tej). Por situata nuk është pozitive edhe në këtë rast. Ka disa biznese që periodikisht hedhin mbetje në vende të pakontrolluara dhe bëhen burime ndotjesh (si p.sh. shkarkimi i mbetjeve të dalin nga nxjerrja e nënprodukteve të qumështit në përroin pas Oblikës që shkakton ndotje të madhe të tij dhe lëshon një erë të pakëndshme për banorët e zonës si dhe për udhëtarët që kalojnë në rrugën afër tij.

2.4 KUSHTET SPECIFIKE DHE NDRYSHIMET SEZONALE

Ndër kushtet specifike që duhen përmendur është dhe prania e doganës së Muriqanit në territorin e kësaj komune. Duke qenë se ajo është një nga pikat më rëndësishme doganore të hyrjes në Shqipëri dhe potenciali i prodhimit të mbetjeve në këtë pikë është i madh.

Ndryshimet sezonale nga analiza e kryer janë shumë të dukshme në këtë komunë. Prodhimi më i madh i mbetjeve është padyshim në stinën e verës. Ky fakt është i lidhur me dy faktorë (i) rritja e numrit të banorëve (kthimi i emigrantëve në vendbanimet e tyre) dhe dy afrimi i sezonit turistik që sjell rritjen e turistëve për zonën por sidomos rritjen e numrit të vizitorëve që hyjnë apo dalin nga Shqipëria që kalojnë "tranzit" në këtë zonë për të mbërritur në doganën e Muriqanit e që si rrjedhim prodhojnë mbetje të tjera shtesë.

2.5 RASTE TË JASHTËZAKONSHME QË PRODHOJNË MBETJE

Ndër rastet e jashtëzakonshme që prodhojnë mbetje mund të përmendim dy raste kryesore:

2.5.1 Prodhimi i mbetjeve plastike nga aktiviteti bujqësor

Komuna Ana e Malit është një komunë me tradita bujqësore dhe pjesa më e madhe e banorëve merren me aktivitete bujqësore si dhe ka një numër biznesesh që lidhen me aktivitete bujqësore (kryesisht kultivimin në sera). Ky lloj aktiviteti kërkon dhe përdorimin e një sasive të madhe materiali plastik (kryesisht plastmase transparente ose me ngjyrë të zezë). Gjatë fazës së zëvendësimit apo të heqjes (që mund të jetë çdo vit ose një herë në disa vjet) duke qenë se ndodh brenda të njëjtës periudhë krijohen sasi të mëdha plastmasi të cilat shpesh lihen në anët e fushave apo më keq akoma digjen në mjedise të hapura.

2.5.2 Përmbytjet

Komuna Ana e Malit bën pjesë në grupin e komunave të rajonit të Nënshkodrës dhe si e tillë është e rrezikuar nga përmbytjet që prekin këtë rajon (sidomos fshati Obot dhe fushat përreth tij). Duke qenë se këto përmbytje në këtë komunë shkaktohen nga dalja nga shtrati i lumit Buna, gjatë këtyre përmbytjeve një sasi e madhe mbetjesh të prodhuara në pjesën e sipërme

të këtij lumi, kryesisht në qytetin e Shkodrës dhe në lokalet dhe aktivitetet e tjera që zhvillohen përgjatë bregut të Bunës shpërndahen në fushat dhe ambientet përreth fshatit Obot dhe mbesin aty gjatë tërheqjes së lumit. Një tjetër problem gjatë përmytjeve është se dhe fshati Obot përmytet gati i gjithi kështu që plani i menaxhimit është munduar që të trajtojë dhe këtë çështje.

3. SKEMA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

3.1 KONSIDERATA PARAPRAKE

Në lidhje me Skemën e Menaxhimit të Mbetjeve janë zhvilluar një sërë konsultimesh me banorët, pushtetin vendor dhe grupet e interesit (bizneset, gratë, të rinjtë) për të vendosur piketat kryesore në të cilat do të përgatitej skema e cila do të duhet të kishte këto atribute kryesore:

- **E thjeshtë** – banorët të mësohen sa më shpejt me funksionimin e skemës dhe kontribuojnë në mirëfunksionimin e saj;
- **E përballueshme financiarisht** – vlera financiare e skemës si në investimin fillestar ashtu dhe në atë periodik të jetë e përballueshme si nga komuna ashtu dhe nga banorët; dhe
- **E segmentuar** – skema e menaxhimit të mbetjeve të ndahet në faza të cilat do të mundësojnë rritjen e cilësisë dhe shtrirjes së skemës gradualisht.

Një tjetër aspekt i marrë parasysh që në fillim ishte dhe mënyra e depozitimi të mbetjeve. Zgjidhja e konsideruar më e favorshme për komunën e Ana e Malit është konsideruar përdorimin e venddepozitimit të Bushatit për shkak të:

- Largësisë jo të madhe që kjo pikë ka me komunën Ana e Malit;
- Cilësisë më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, i cili është specifikisht i ndjeshëm (pasuritë natyrore të mëdha, veçanërisht lumi Buna), duke mënjanuar një pikë ndotje të re dhe krejtësisht të pamenaxhueshme në komunë;
- Vështirësisë që kanë banorët për të pranuar pika të grumbullimit të mbetjeve në komunën e tyre, dhe
- Imazhit “Komunë pa plehra” që ato duan të transmetojnë tek vizitorët që qëndrojnë apo kalojnë “tranzit” në këtë komunë.

3.2 NDARJA NË FAZA

Plani i menaxhimit të mbetjeve në këtë komunë është ndarë në tre faza. Fazat janë menduar që të ndjekin njëra tjetrën në një interval pesë vjetësh por kjo periudhë kohore është e varur fortësisht dhe me aftësinë e komunës për të zbatuar në mënyrë të suksesshme skemën në të gjitha pikat e saja. Për më tepër kalimi nga njëra fazë në tjetrën është e lidhur potencialisht dhe me shtesa në investime si dhe me përditësim të kostove për shkak të luhatjeve që ato mund të kenë gjatë këtyre periudhave.

3.3 FAZA I

Kjo fazë përfshin intervalin kohor maj 2011 deri në maj 2015. Në këtë fazë është parashikuar shtrirja e skemës në tre fshatrat kryesorë të kësaj komune (Oblikë, Murriqan dhe Obot). Përzgjedhja e këtyre fshatrave që në skemën fillestare është bërë për arsytet e mëposhteme:

- Janë tre fshatrat më të mëdhenj të komunës Ana e Malit (78% e popullsisë jeton në këto tre fshatra);
- Të tre fshatrat kanë infrastrukturë rrugore të përshtatshme për kalimin e kamionëve teknologjikë për transportin e mbetjeve;
- Numri më i madh i bizneseve dhe institucioneve ndodhet në këto fshatra;
- Fshati Oblikë është qendra e komunës;
- Fshati Murriqan është fshat kufitar me Malin e Zi ku ndodhet dhe pika e rëndësishme doganore e Murriqanit;
- Fshati Obot është një nga fshatrat më të prekur nga përmytjet e lumit Buna dhe ndotjet që ai sjell.

3.3.1 Investimi fillestar

Para se të llogaritet investimi fillestar është bërë llogaritja e sasisë së mbetjeve të prodhuar në këto tre fshatra. Pasi u morën parasysh një sërë faktorësh (shih Kapitullin 2) rezultoi se këto tre fshatra prodhojnë një sasi prej 2.9 ton mbetje në ditë apo rreth 20.2 ton në javë.

Duhet thënë se gjatë hartimit të planit u morrën parasysh dhe kufizimet financiare. Ky plan parashikon një vlerë prej 35 000 Euro investime fillestare konkrete të cilat do të vijnë si bashkëfinancim i projektit dldp dhe komunës Ana e Malit. Kjo vlerë është mbajtur si vlerë limit në përcaktimin e investimeve fillestare.

Nga llogaritjet e bëra duke pasur parasysh hartën e zonës (shih Aneksin 1) dhe kapacitetin e kazanëve të mbledhjes së mbetjeve u vlerësua se për një mbledhje të suksesshme të mbetjeve do të duhen 50 kazanë të cilët do të vendosen përkatësisht: 30 kazanë për fshatin Oblikë, 15 kazanë për fshatin Murriqan dhe 5 kazanë për fshatin Obot. Komuna mund të ketë në dispozicion dhe 3-5 kazanë të tjerë të cilët mund të përdoren si rezervë në rastet e zëvendësimit apo të riparimit të kazanëve të rinj. Plani i propozuar e vendosjes së kazanëve është paraqitur në Harta 1.1, 1.2 dhe 1.3. Pikat e propozuara janë përcaktuar duke marrë parasysh (i) mbledhjen sa më afër të një numri shtëpish, (ii) distancën më ta afërt të banorëve me pikën e grumbullimit të mbetjeve, (iii) afërsinë më rrugën, (iv) mundësinë e mbërritjes dhe manovrimit të makinës teknologjike dhe (v) vendet aktuale abuzive të hedhjes së mbetjeve, apo tendecës që kanë banorët për të hedhur mbetjet.

U gjykua që 50 kazanët të blihen të rinj dhe të formatit më të përdorëshëm (kapaciteti 1.1 m³). Vlera e përgjithshme që mendohet se nevojitet për këtë blerje është 1 540 000 Lekë.

Investimi tjetër shumë i rëndësishëm fillestar është ai i makinës teknologjike. Kjo makinë duhet të ketë karakteristikat e përshtatshme që të mund të përpunojë (shkarkim të shpejtë)

konteinerët prej 1.1 m³ dhe të ketë një kapacitet mbajtës prej të paktën 8 m³ mbetje. Nga analiza paraprake e kryer u pa se do të ishte e pamundur blerja e një kamioni të ri teknologjik pasi kosto do të dilte e papërbalueshme nga komuna. Blerja e një kamioni të tillë përdorur por në gjendje pune mund të kapë vlerën e së paku 3 360 000 Lekë që është e përbalueshme dhe është brenda fondit limit të përcaktuar për kazanët dhe kamionin.

Ky investim fillestar parashikon që kazanët të vendosen në tre fshatrat e përmendur dhe që kamioni teknologjik të mbledhë dy herë në javë mbetjet dhe t'i dërgojë ato në venddepozitimin e Bushatit.

3.3.2 Burimet njerëzore

Bazuar mbi skemën e parashikuar në fazën e parë (50 kazanë + një kamion dy herë në javë shërbim u vendos që të angazhohen këto burime njerëzore:

1. Një person nga administrata e komunës të angazhohet për funksionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Ky person përgjegjës për SMB do të caktohet nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Këshillin e Komunës. Detyrat e këtij personit përgjegjës për SMB janë përcaktuar në Shtojcën 2.1.
2. Një shofer me kohë të pjesshme që do ta drejtojë makinën dy herë në javë nga fshatrat për në venddepozitimin e Bushatit. Detyrat e shoferit janë përcaktuar në Shtojcën 2.2.
3. Dy punëtorë me kohë të pjesshme për të kryer mbledhjen dhe ngarkimin e mbetjeve në fshatra deri në transportimin e tyre për në venddepozitimin e Bushatit. Detyrat e dy punonjësve janë përcaktuar në Shtojcën 2.3.

Është për t'u theksuar se angazhimi i këtyre katër punonjësve nuk është shumë problematik nga ana financiare. Personi përgjegjës nga administrata është aktualisht i paguar nga buxheti i komunës kështu që nuk ka nevojë për financim shtesë. Po ashtu dhe dy punëtorë me kohë të pjesshme janë të angazhuar që tani në komunë dhe merren me aktivitetet të ndryshme pastrimi etj. Si rrjedhojë e vetmja shtesë reale për t'u përbaluar nga komuna është punësimi i një shoferi me kohë të pjesshme. ***Sidoqoftë, për të siguruar eficienten e skemës, pagesa e punëtorëve dhe e shoferit është llogaritur si kosto operative e skemës së menaxhimit të mbetjeve.***

3.3.3 Çështjet ekonomike

Një nga çështjet më të mprehta që hasen në hartimin e një plani të menaxhimit të mbetjeve është hartimi i kuadrit të politikave financiare. Ndër aspektet më kryesore që plani duhet të adresojë mund të përmendim:

- Eficienten maksimale të fondeve të harxhuara me parimin "të bësh shumë duke pasur pak";
- Planifikim i kujdesshëm i kostove operative duke i dhënë atyre të njëjtën peshë apo më shumë se kostot e investimit; dhe
- Arrijen e qëndrueshmërisë së skemës financiare që arrihet duke siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe për riparimin apo zëvendësimin e pajisjeve dhe

investimeve afatgjata. Për këtë hap, kalimi nga kontributet në lekë apo donacionet drejt pagesës së rregullt nga konsumatori është i domosdoshëm.

Nga ana tjetër, Komuna Ana e Malit është një komunë që nuk ka pasur një sistem funksional të menaxhimit të mbetjeve dhe si rrjedhojë dhe kontributi i banorëve të zonës pothuaj nuk ka ekzistuar. Për më tepër zona është një zonë me të ardhura mesatare dhe si rrjedhim është pasur kujdes me caktimin e tarifës për të mos inkurajuar refuzimin apo evazionin nga ana e banorëve.

Këto dy çështje si dhe më e rëndësishmja, kërkesat reale që ka një sistem aktual i menaxhimit të mbetjeve, kanë qenë faktorët kryesorë që kanë formëzuar sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

Në kostot operative që janë përlogaritur (vlerat janë marrë nga çmimet e tregut apo krahasuar me skema të ngjashme të zbatuara në rajon) janë llogaritur këto shpenzime:

- Shpenzime për mirëmbajtjen dhe amortizimin e kamionit teknologjik si dhe mirëmbajtjen e konteinerëve;
- Shpenzime për dezinfektimin e zonës përreth konteinerëve (gëlqere pluhur);
- Blerje periodike të mjeteve të konsumit për punëtorët (veshmbathje, vegla pune etj.);
- Blerje vjetore e karburantit për kamionin e transportimit të mbetjeve;
- Pagesa mujore e punëtorëve dhe shoferit me kohë të pjesshme; si dhe
- Pagesa e tarifës për depozitimin e mbetjeve në venddepozitimin e Bushatit (rreth 7 euro/ton).

Duke qenë se një nga kostot kryesore është ajo e blerjes së karburantit është llogaritur dhe itinerari i lëvizjes së makinës (shih Shtojcën 3) dhe koha qëndrimit dhe lëvizjes së saj për të pasur një përlogaritje të sasisë së karburantit sa më afër realitetit.

Bazuar në përlogaritjet e mësipërme rezulton se kosto operative që duhet të përballohet për mirëfunksionimin e fazës I është 2 615 000 Lekë.

3.3.4 Llogaritja e tarifës

Siç është paraqitur dhe më sipër kjo fazë është parashikuar të funksionojë për një periudhë 5 vjeçare e si rrjedhojë dhe skema e tarifave është paraqitur si skemë 5-vjeçare.

Kjo skemë 5 vjeçare ka marrë parasysh këto parametra:

- Komuna Ana e Malit do të ketë rritje të popullsisë bazuar vetëm në rritjen natyrale të komunës dhe jo nga lëvizje masive migracionale;
- Rritja e kostove për shkak të inflacionit do të jetë jo më shumë se 2% në vit;

Kosto e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, sipas viteve, në lekë.	
Viti	Faza I
2011	2,710,320
2012	2,764,527
2013	2,819,817
2014	2,876,214
2015	2,933,738

- Paguesa nga ana e banorëve do të mbulojë 80% kostos operacionale për dy vitet e para, 90% të kostos operacionale dy vitet e tjera dhe që nga viti i pestë nuk do të ketë nevojë për subvecionim nga komuna.

3.3.5 Shpërndarja e detyrimeve

Kosto operative do të mbulohet nga bashkësia e Komunës Ana e Malit. Kjo do të thotë që të gjithë subjektet që prodhojnë mbetje duke filluar që nga individët e deri tek biznesi duhet të paguajnë për të mbajtur pastër mjediset ku ushtrojnë aktivitetin jetësor.

Shpërndarja e kostove ka qenë objekt i gjatë diskutimi dhe ishte objekti kryesor i një takimi të gjerë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në komunë ku përpara tyre u vendosën disa alternativa të ndryshme për të parë sesi ishte pritshmëria e tyre. **Pas diskutimeve u ra dakort që banorët të mbulojnë 70% të kostos, bizneset 28% të kostos dhe institucionet 2% të saj.**

Nga diskutimet u ra dakord që pagesa e taksës për mbetjet të ishte e diferencuar sipas ndarjes së zakonshme *p.sh.* tarifë e veçantë për familjet, tarifë e veçantë për institucionet dhe tarifë e veçantë për bizneset. Përmbledhja e pagesës së parashikuar për çdo grup për pesë vitet në vazhdim sipas fazës së parë është paraqitur në tabelën e mëposhtëme:

Pagesa vjetore	2011	2012	2013	2014	2015
Familje	1,077	1,099	1,261	1,286	1,457
Biznese	12,648	12,901	14,804	15,100	17,113
Institucione	1,807	1,843	2,115	2,157	2,445

Tarifa e familjeve pasi është diskutuar me grupet e interesit dhe me banorë të zonës është quajtur si e pranueshme. Gjithashtu dhe bizneset deri tani kanë paguar një sasi parash për të zhvendosur mbetjet nga territori i tyre e si rrjedhim dhe pagesa nuk do të jetë e papërbalueshme për to.

Një diskutim tjetër i kryer me banorët dhe palët ishte dhe mënyra e pagesës. Me mirëkuptimin e të gjithëve u vendos që mbledhja e këtyre detyrimeve do të kryhet në një zë të veçantë "taksë pastrimi" por që do të inkuadrohet në taksat e tjera vjetore.

Skema e mësipërme presupozon që investimi fillestar do të bëhet me bashkëfinancimin e parashikuar midis dldp dhe komunës. Në rast se ky bashkëpunim nuk mbyllet me sukses, shpenzimet për investimin fillestar mund të kërkojnë mënyrë tjetër financimi (kredi, apo mbulim nga fondet e komunës) për të cilat do duhet përlogaritur skemë tjetër kontributesh (në këtë rast mund të duhet që dhe një pjesë e kostove të investimit të mbulohet nga skema).

Në mënyrë që të lehtësohet bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis aktorëve të ndryshëm si dhe komunës që mban përgjegjësinë kryesore për mirëmbajtjen e skemës si dhe që të qartësohen sa më shumë aspektet e planit u përgatit dhe një letër sqaruese për anëtarët e këshillit të

komunës në të cilën janë paraqitur shkurtimisht të gjithë hapat e planit. Kjo shkresë është paraqitur në Shtojcën 4.

3.4 PARIMI “NDOTËSI PAGUAN”

Ky parim është padiskutim baza e funksionimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve, por jo vetëm. Si parim bazë në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, ai përcakton qartë se kush ndot duhet të paguajë. Mënyrat apo format e zbatimit të këtij parimi mund të jenë të ndryshme dhe të vendosen në kohë dhe afate të ndryshme. Megjithatë, për komunën Ana e Malit, ky parim duhet të filloj të funksionuari, menjëherë pas vendosjes së sistemit të menaxhimit të mbetjeve në punë. Kjo, do të thotë që të gjithë prodhuesve, subjekt të këtij plani, do t'u bëhet e ditur se mbajnë përgjegjësi ligjore në rast të ndotjes së mjedisit, duke përfshirë:

- Hedhje të mbetjeve jashtë pikave të grumbullimit;
- Hedhjes së mbetjeve të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë plan, në kazanët e mbetjeve;
- Ndotje të tokës apo rrymave ujore;
- Depozitim i lëndëve të rrezikshme në territorin e komunës;
- etj.

Sanksionet, e shkeljes së këtyre normave, përcaktohen në ligj dhe mënyrat e ndëshkimit gjithashtu. Për zbatimin me sukses të këtij parimi, komuna do të bashkëpunojë me Agjencinë e Ruajtjes së Mjedisit Shkodër, si autoritet monitorues dhe ndëshkues.

3.5 FAZA II

Kjo fazë parashikohet që të jetë vazhdim i fazës së parë të skemës së menaxhimit të mbetjeve dhe si e tillë mendohet që mund të përfshijë intervalin kohor **2015 deri 2019**. Kjo fazë përfshin futjen e të gjithë fshatrave në skemën e menaxhimit të mbetjeve. Në fakt, disa nga fshatrat që figurojnë si pjesë e komunës Ana e Malit janë gati plotësisht të braktisur. Këto fshatra (Bobot, Vidhgar, Vallas dhe Dramosh) në 20 vitet e fundit kanë përjetuar braktisjen e tyre nga fshatarët, të cilët ose kanë qëndruar në komunë, por kanë zbritur në zonat fushore ose janë transferuar në zona të tjera brenda apo jashtë Shqipërisë. Një nga arsyt kryesore për këtë transferim është dhe mungesa e infrastrukturës së duhur rrugore për të shkuar në këto fshatra. Nga ana tjetër, për shkak të këtyre lëvizjeve janë shtuar zonat e populluara në zonën fushore të komunës, të cilat mund të konsiderohen si fshatra të rinj apo lagje të fshatrave të mëdhenj, siç është Alimetaj. Këto zona do të merren parasysh në skemën e menaxhimit të mbetjeve për të gjithë komunën.

3.5.1 Investimi fillestar

Në llogaritjen e investimit fillestar janë marrë parasysh të njëjtët faktorë si ato të fazës së parë, por pa marrë parasysh kufizimet financiare (duke qenë se mendohet se deri në vitin 2015 mund të ketë fonde të tjera të disponueshme).

Investimi fillestar parashikon rritjen e numrit të kazanëve në 150 copë. Numri i rritur i kazanëve nuk parashikon vetëm plotësimin me kazanë të fshatrave në të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në fazën e parë por dhe të vendosjes së kazanëve në mënyrë më kapilare në tre fshatrat e fazës së parë për të rritur akoma më shumë cilësinë e mbledhjes së mbetjeve në të gjithë pjesët e fshatrave.

Mendohet se gjenerimi ditor i mbetjeve do të jetë në nivelin e 3.7 ton në ditë kështu që përdorimi i vetëm një kamioni me kohë të pjesshme është i mjaftueshëm.

Duke marrë si të pandryshuar çmimin e kazanëve dhe të kamionit teknologjik të përdorur vlera e investimit fillestar është 7.980.000 lekë (në total) ose 3.000.000 lekë më shumë për t'u shtuar krahasuar me fazën e parë.

3.5.2 Burimet njerëzore

Skema për fazën e dytë të burimeve njerëzore parashikon që të përdoren të njëjtat burime njerëzore si ato të parashikuara për fazën e parë. Kjo do të thotë se do të përdoren përsëri të njëjtat burime njerëzore që janë të mjaftueshme dhe për mbarëvajtjen e fazës së dytë.

3.5.3 Çështjet ekonomike

Pjesa kryesore e parimeve të ndjekura për përlogaritjen e kostove ekonomike që lidhen me zbatimin e skemës së menaxhimit të mbetjeve është paraqitur që në shpjegimin e fazës së parë.

Ndryshimet më të mëdha që ka faza e dytë në krahasim me fazën e parë në terma ekonomi janë:

- (i) Vlerë më e lartë pagese për venddepozitimin e Bushatit për shkak të rritjes së sasisë së mbetjeve të mbledhura;
- (ii) Rritje e karburantit të harxhuar për shkak të lëvizjeve më të mëdha që ka makina teknologjike nëpër të gjithë fshatrat (10 km më shumë për çdo rrugë); dhe
- (iii) Rritje të kostove operative (p.sh. mirëmbajtje kazanësh, amortizim mjete, material dezinfektues etj.)

Duke llogaritur me të njëjtën metodologji që është përdorur për fazën e parë është parë që vlera e kostos operative që do të duhet të përballojë komuna për fazën II në vitin 2015 është 3.790.548 Lekë.

Llogaritja e kësaj vlere krahasuar me fazën e parë është shumë më pak e saktë. Kjo sepse shpenzimet e kësaj faze janë llogaritur duke pasur parasysh çmimet e sotme për artikujt dhe shërbimet dhe vendosur një tarifë rritje vjetore prej 2%. Duke qenë se kjo tarifë llogaritet për një periudhë 5-10 vjeçare krahasuar me 2011 është e pamundur që të parashikosh se me sa përqind do të rriten realisht vlerat e karburantit, tarifa e venddepozitimit etj.

3.5.4 Llogaritja e tarifës

Ndryshe nga faza e parë në këtë rast të gjitha kostot operative do të mbulohen direkt nga banorët bizneset dhe institucionet dhe nuk do të ketë subvencionim nga komuna. Tabela e kostove të sistemit për vitin 2015-2019 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Viti	Vlera (në Lekë)
2015	3,790,548
2016	3,866,359
2017	3,943,686
2018	4,022,560
2019	4,103,011

Skema e shpërndarjes së këtyre kostove është e njëjtë më atë të paraqitur për fazën e parë. Bazuar mbi këto llogaritje pagesa për çdo kategori paguesish është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	2015	2016	2017	2018	2019
Familje	1,883	1,921	1,959	1,998	2,038
Biznese	22,112	22,554	23,005	23,465	23,934
Institucione	3,159	3,222	3,286	3,352	3,419

3.6 FAZA III

Faza e tretë, ka si qëllim zgjidhjen e problemeve të konsideruara të vjetra dhe që kanë të bëjnë me zonat e ndotura me mbetje si dhe të mundësojë ndarjen e mbetjeve si proces pilotimi. Më konkretisht kjo fazë do të konsistojë në këto ndërhyrje:

- a) **Rehabilitimi i zonave të nxehta.** Këto zona janë kryesisht të shtrira përgjatë përrrenjve të Millës dhe atij të Megjureshit. Këta përrrenj janë përdorur nga banorët dhe nga nga vetë komuna për depozitimin e mbetjeve, në mungesë të një fushe depozitimi. Kjo është padyshim një praktikë e keqe dhe ka shkaktuar një ndotje të madhe sidomos në fshatin kryesor të komunës, Oblikën. Sasia e mbetjeve të depozituara në këtë fshat është shumë e madhe dhe shkakton disa lloj problemesh, si ato mjedisore ashtu dhe shëndetësore.

Kjo fazë, megjithëse e renditur si e tretë, do të mund të ketë dy përjasje: a) përjasja e parë ka të bëjë me fillimin e punës për identifikimin e nevojës për përmirësimin gjendjes dhe gjetjen e donatorëve; dhe b) përjasja e dytë ka të bëjë me fuqizimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, për të mundësuar më shumë para për të ndërhyrë në një periudhë të largët në rast se problemi nuk është zgjidhur.

Për këtë, ky plan ka të bashkëlidhur fishën përkatëse të projektit, i cili do t'i paraqitet financuesve të mundshëm që janë qeveria shqiptare, donatorët ndërkombëtar apo biznese e individë të interesuar për të mbështetur komunën dhe banorët e saj.

Gjatë, komunikimit me banorët dhe vizitat në terren janë vërejtur shqetësime të shumta për zona "të nxehta" në komunë, të cilat kërkojnë zgjidhje për të ulur nivelin e ndotjes që ato shkaktojnë.

Për depozitimin e mbetjeve të këtyre zonave do të shikohet mundësia brenda territorit të komunës, në zona të vjetra ushtarake apo terren jo shumë depërtuese në ujrat nëntokësore.

- b) **Futjes së risive në menaxhimin e mbetjeve.** Kjo, ka të bëjë me organizimin e sistemit të mbetjeve për të mundësuar ndarjen e mbetjeve në burim dhe depozitimin e tyre në mënyrë të veçantë.

Mundësia për të vendosur këtë skemë është paraqitur që në fazën e parë dhe disa nga banorët janë të gatshëm për t'iu përgjigjur kësaj mundësie. Megjithatë, vendosja dhe menaxhimi në mënyrë të ndarë kërkon më shumë angazhim nga banorët dhe kostot shtesë për sistemin e menaxhimit.

Ekipi i menaxhimit të mbetjeve, me anë të mjeteve të komunikimit do të shikojë mundësinë e diskutimit të kësaj skeme dhe të vlerësojë vazhdimisht interesin e banorëve dhe sidomos biznesit. Në rast të një përjasje pozitive, një përlogaritje e investimit është e nevojshme. Fillimisht mund të investohet në komunën Oblikë dhe në shkollat e komunës ku mund të vendosen dy kazanë shtesë, për letrën dhe për plastikën. Kosja për të investim mund të jetë rreth 300.000 lekë (10 kazanë x 30.000 lekë). Ndërkohë që për transportimin e tyre, duhet të mundësohet një mjet tjetër, ose të arrihet një mirëkuptim me Bashkinë Shkodër për ta grumbulluar në një ditë të caktuar këtë mbetje, kundrejt një kostoje.

Në të ardhmen, me fuqizimin dhe të kompanive ricikluese, mbetjet e letrës dhe të plastikës do të mund të mblidhen nga këto kompani falas, ose më mirë akoma kundrejt një përfitimi për komunën.

3.7 RI-INVESTIME

Megjithëse në të dy fazat në përlllogaritjen e kostove operative janë llogaritur dhe kostot e amortizimit dhe të përdorimit të mjeteve kryesore që do të përdoren duke pasur parasysh që vlerat e tarifave llogariten në potencialin maksimal të prodhimit të mbetjeve, komuna do të mbajë një pjesë të vogël të lekëve të mbledhura (në varësi dhe të efikasitetit të mbledhjes së tarifës kjo vlerë mund të jetë nga 100 000 deri 250 000 Lekë në vit) për t'i pasur si fond rezervë që do të shërbejë për t'u përdorur në rastet e zëvendësimit të kazanëve apo dhe të kamionit teknologjik.

4. PLANI I NDËRGJEGJËSIMIT DHE EDUKIMIT TË KOMUNITETIT

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit është çështja më e rëndësishme e zbatimit me efikasitet të planit. E gjithë veprimtaria e tij dhe përmirësimi i mëtejshëm janë direkt të lidhura me përkrahjen që do të vijë nga banorët dhe aktorët në komunë. Një program i mirë dhe efikas ndërgjegjësimi dhe edukimi do të mundësojë një mjedis më të shëndetshëm dhe shëndet më të mirë.

Grumbullimi i tarifës është çështja më kryesore për zbatimin e planit dhe për këtë që në fazën e parë të zbatimit të tij, do të punohet shumë me rritjen e ndërgjegjës së banorëve, në mënyrë që kjo të ketë efektin e saj direkt në grumbullimin e tarifës.

Më poshtë janë shpjeguar në detaje veprimtaritë përkatëse dhe rolin e secilit aktor në këtë proces, për të mundësuar një kuptim më të thjeshtë zbatimit të tij

4.1 OBJEKTIVAT E PNEK

Objektivat kryesore të PNEK për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve janë:

- 1) Të informojë publikun në skemën e re të menaxhimit të mbetjeve dhe kërkesave që parashtrihen në të;
- 2) Të arrijë mbështetjen e komunitetit dhe tarifë-paguesit e tjerë mbi masat dhe nismat që përcaktohen në PMM;
- 3) Të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme PMM.

Principet kryesore të PNEK:

- a) Menaxhimi i mbetjeve është një shërbim i ri për komunitetin dhe kështu do të ketë ndikime të ndryshme në sjelljen dhe ekonominë e familjeve. Ndaj kjo çështje duhet të trajtohet me vëmendje maksimale, në mënyrë që komuniteti të kuptojë se ky shërbim është plotësisht në përbushje të nevojave të tij;
- b) Departamenti i Menaxhimit të Mbetjeve në Komunë duhet ta drejtojë vetë programin e ndërgjegjësimit dhe edukimit, por megjithatë si funksion ai mund t'i delegohet dhe shoqërisë civile apo shkollave, sipas një marrëveshje të qartë mes palëve;
- c) Shqyrtimet apo vlerësimet janë një formë e informimit të publikut dhe duhet të përdoren si mundësi për një kuptim më të qartë të çështjeve të PMM;

Adresimi i të gjithë aktorëve përgjatë të gjithë procesit të zbatimit të PMM është një çelës i suksesit dhe qëndrueshmërisë;

Është e rëndësishme të arrihet një pjesëmarrje aktive e komunitetit në të gjitha fazat e zbatimit të planit, në mënyrë që të mundësohet kuptim më i drejtë dhe transparencë në menaxhim, sidomos atij financiar.

4.2 VLERËSIMI I GJENDJES DHE MUNDËSIVE AKTUALE

Komuna aktualisht nuk zotëron mjete ndërveprimi të komunikimit të publikut. Në komunë mungojnë zyrat e informacionit për shërbimet, nuk zhvillohet një proces konsultimi me banorët në mënyrë të rregullt dhe nuk ka një staf të përcaktuar për të punuar për informimin. Në komunë nuk ka radio apo stacione TV vendore, si dhe nuk ka një gazetë të komunës. Gjithashtu, në komunë nuk ushtron veprimtari asnjë OJF mjedisore, përveç atyre kulturore dhe fetare.

PMM përcakton këtë si një nevojë të menjëhershme për t'u adresuar dhe përmirësuar, pasi është mëse e qartë se banorët e zonës janë shumë aktivë, sa herë që i kërkohet të marrin pjesë në veprimtari. Në procesin e përgatitjes së këtij plani është vënë re një dëshirë e madhe sidomos e të rinjve për t'u angazhuar në procese të diskutimit dhe të veprimtarive në natyrë. Të rinjtë shprehen vazhdimisht se do të ishin të gatshëm të ngrinin grupet e diskutimit shtëpi më shtëpi dhe për më tej të bashkëpunonin me komunë për të të përcjellë mesazhet dhe shqetësimet në komunitet dhe anshjelltas. Gjithashtu, gratë janë shumë të interesuara të jenë aktive në grupet e interesit dhe të flasin me komunitetin për shqetësimet shëndetësore dhe mjedisore.

Bazuar në gjetjet e këtij procesi dhe në njohjen e pikave të forta të komunitetit, ky plan do të punojë hap pas hapi në aktivizimin e këtyre burimeve dhe forcimin e sistemit të menaxhimit.

4.3 MJETET E MUNDSHME TË KOMUNIKIMIT DHE INFORMIMIT

Fushatat e Ndërgjegjësimit dhe Informimit të Publikut mund të marrin forma nga më të ndryshmet. Disa nga këto mund të jenë fletëpalosje informative, dëgjesa publike, programe në radio, reklama, leksione dhe ndërhyrje në kurrikulën e shkollës. Hapi i parë i rëndësishëm do të konsistojë në informimin e komunitetit mbi sistemin e ri, i cili do të vihet në praktikë dhe se gjendja do të ndryshojë për të mirën e tyre dhe përmirësimin e gjendjes së deritanishme.

Mjetet, të cilat do të përdoren, sipas rastit dhe mundësisë financiare dhe njerëzore do të jenë:

a) Niveli i parë i mjeteve, të cilat kërkojnë angazhim minimal:

1. **Edukim në shkallë të gjerë siç janë;**
 - 1.1. Artikuj në gazetatat, të cilat shpërndahen në zonë;
 - 1.2. Fjalime të ndryshme nëpër aktivitete të ndryshme;
 - 1.3. Shfrytëzimi i rasteve të pjesëmarrjes së zyrtarëve të komunës në emisione në radio apo televizionet lokale;
 - 1.4. Njoftime të ndryshme, të cilat kryhen nga ndërmarrja e menaxhimit të mbetjeve, të tilla si ngjitës me mesazhe të ndryshme në makina apo kazanë.
2. **Fjalime speciale në;**
 - 2.1. Shkolla;
 - 2.2. Klube;
 - 2.3. Pranë grupeve të interesit apo OJFve;

2.4. Takime të ndryshme publike për këtë rast apo të tjera;

3. **Ndërtimi i një faqe të thjeshtë interneti**, duke u bazuar në faktin që banorët janë shumë të interesuar ndaj përdorimit të internetit dhe kështu mund të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe në përcjelljen e mesazheve të tyre mbi opinionet, vërejtjet apo pjesëmarrjen në veprimtari;
4. **Konkurs për përgatitjen e një posterit**. Për këtë mund të angazhohen nxënësit e shkollave në mënyrë që të sjellin idenë më të mirë dhe më rinore për përcjelljen e një mesazhi me anë të posterit;
5. **Aktivitetet në rrugët e komunës**, së bashku me banorët, duke përzgjedhur tema të ndryshme interesante. Në këto veprimtari mund të marrin pjesë grupet e ndryshme të interesit, por më kryesisht të rinjtë;
6. **Vizita shtëpi më shtëpi**, të kryesuara nga kryetarët e fshatrave apo dhe të rinjtë, për të folur mbi problematikën e mbetjeve, çështje të ndryshme që i shqetëson banorët, etj;
7. **Ngritja e komiteteve të lagjeve apo fshatrave**, të cilat mund të diskutojnë për çështje të ndryshme të ndërgjegjesimit në lidhje me shëndetin publik, mjedisin dhe mbetjet e ngurta.
8. **Nxitja e ngritjes së OJFve mjedisore** apo të të rinjve, të cilat të angazhohen në veprimtari të ndryshme, gjetje fondesh në mbështetje të sistemit dhe të mbrojtjes së mjedisit.

b) Niveli i dytë i mjeteve, të cilat kërkojnë angazhim mesatar:

1. **Ndërtimi i një faqe interneti më të avancuar**, e cila jo vetëm infomon, por dhe jep të dhëna mbi veprimtaritë e shërbimeve, financat dhe mundëson një shërbim më të integruar diskutimi;
2. **Ngritja e një qendre për pritjen e ankesave të publikut**, e cila mund të jetë e gërshetuar me shërbime të tjera. Kjo qendër mund të zhvillohet më tej në një "one stop shop", duke mundësuar më shumë shërbime dhe cilësi shërbimi;
3. **Telefon i gjelbër**, i cili mund të presë njoftime apo ankesa nga banorët sa herë shikojnë një problematikë;
4. **Prodhimi i dokumentave informativë**, si:
 - 4.1. Gazeta e komunës për shërbimet;
 - 4.2. Fletëpalosje tematike;

- 4.3. Postera informues dhe ndërgjegjësues;
 - 4.4. Fletë informative për specifika të ndryshme, siç mund të jetë kuptimi i mbetjeve apo ditët e veçanta të grumbullimit të mbetjeve të veçanta;
 - 4.5. Paketa edukimi për shkollat sipas nivelit të tyre;
5. **Organizimi i ngjarjeve të veçanta publike, të tilla si:**
 - 5.1. Konferencë për shtyp;
 - 5.2. Ngjarje edukative në mjedise të hapura;
 - 5.3. Takimi pune apo trajnuese në zona të veçanta;
6. **Projekte të përfshirjes së komunitetit, të tilla si:**
 - 6.1. Promovimi i ditëve të veçanta mjedisore;
 - 6.2. Projekte pilote të ndarjes së mbetjeve;
 - 6.3. Ndërtimi i javës së pastrimit me grupe të ndryshme të komunitetit, në zona të ndotura, ku duhet rritur më shumë vëmendja;
 - 6.4. Projekte rinore për edukim dhe pastrim vullnetar;

c) Niveli i tretë i mjeteve, të cilat kërkojnë angazhim të lartë:

1. Ndërtimi dhe përmirësimi i mesazhit dhe identitetit të ndërmarrjes;
 - 1.1. Përgatitja e një logoje ndërgjegjësuëse;
 - 1.2. Lyerja dhe mbajtja pastër e të gjitha aseteve të ndërmarrjes si dhe të komunës;
 - 1.3. Uniforma të plota për stafin e ndërmarrjes;
2. Punësimi i një zyrtari, i cili merret me marrëdhëniet me publikun dhe shpërndarjen e informacionit:
 - 2.1. Për publikun
 - 2.2. Për biznesin dhe institucionet;
3. Integrimi i çështjeve të menaxhimit të mbetjeve në shkolla, nëpërmjet:
 - 3.1. Futjes në ekstra-kurrikul e edukimit mjedisor apo të shëndetit. Për këtë mund të përdoren më tej programet, të cilat janë tashmë në sistem, siç është "Paketa e Gjelbër" e përgatitur nga REC Shqipëri. Ko modul ka një temë specifike për sjelljen konsumatore, e cila është shumë e përshtatshme për t'u zhvilluar me nxënësit dhe më gjerë;
 - 3.2. Prezantimi i dokumentarëve apo filmave të ndryshëm në shkollë, siç është "Planeti Plastik", i sjellë në shqipëri nga REC Shqipëri dhe që flet mbi rrezikun e plastikës në jetën tonë;
 - 3.3. Organizimi i takimeve të punës apo trajnimeve me mësuesit;
4. Ndërtimi dhe zbatimi i një fushate reklamimi, duke përdorur:
 - 4.1. Shtypin e shkruar, për të promovuar sistemin, por dhe për të bërë më shumë të dukshme nevojat për bashkëpunim dhe ndihmesë në përmirësimin e gjendjes;

4.2. Vendosja e standave informative në vende publike, ku të flitet për elementë imediatë të menaxhimit;

4.4 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PNEK

Aktorët	Interesi	Roli/Përgjegjësia
Komuna	<ul style="list-style-type: none"> Të përmirësojë gjendjen e mbetjeve në komunë dhe të sigurojë mjedis dhe shëndet të mirë për banorët; Të sigurojë që banorët kanë kuptuar drejt qëllimin e këtij shërbimi dhe të arrijë efikasitetin financiar të nevojshme për menaxhimin e qëndrueshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> Shpërndajë informacion për të gjithë aktorët e tjerë; Organizojë, zhvillojë apo bashkëzhvillojë të gjitha veprimtaritë e përcaktuara në PNEK; Përgatisë materiale informuese dhe ndërgjegjësuese; Të mbajë kontakt të vazhdueshëm me komunitetin mbi menaxhimin e mbetjeve; T'i përgjigjet nevojave dhe të tregojë besueshmëri dhe angazhim; Të zgjidhë problemet e kordinimit dhe bashkëveprimit; Të mbajë në efikasitet të plotë ndërmarrjen e menaxhimit nga të gjitha aspektete;
Qendrat shëndetësore	<ul style="list-style-type: none"> Të sigurojnë shëndet të mirë për banorët; 	<ul style="list-style-type: none"> Të marrin pjesë aktive në diskutimet tematike, sidomos lidhur me shëndetin, për të bërë të qarta rrezikun që vjen nga ndotja; Të ndihmojnë komunën në përgatitjen e materialeve informative të sakta dhe të thjeshta për banorët; Të marrin pjesë në fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi, si pastrime vullnetare;
Kryetarët e fshatrave	<ul style="list-style-type: none"> Të sigurojnë nivel të lartë të shërbimit dhe të pjesëmarrjes së banorëve; Të sigurojnë shëndet të mirë dhe mjedis të pastër. 	<ul style="list-style-type: none"> Organizojnë takime shtëpi me shtëpi me banorët, për të përcjellë më afër çështjet e ndryshme; Të marrin pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë e organizuara nga komuna, si dhe të sigurojnë që të gjithë banorët e marrin mesazhin nëpërmjet pjesëmarrjes apo përcjelljes nga kryetarët; Të mundësojnë takime të veçanta në secilin fshat dhe të shpërndarjnë materiale informative dhe pyetësorë të kënaqshmërisë; Informojnë komunën mbi çështje të

		ndryshme të performancës, përmirësimit të shërbimit dhe skemës.
Shkolla (mësues dhe nxënës)	<ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojë shëndet dhe mjedis të shëndetshëm për të rinjtë; • Edukojë drejtë brezin e ri mbi nevojën për zhvillim të qëndrueshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojnë krijimin e grupeve apo organizatave me bazë rinore dhe fokus në çështjet mjedisore; • Të organizojnë veprimtari të ndryshme edukative, ndërgjegjësuese, si në shkollë ashtu dhe jashtë saj; • Të marrin pjesë në mënyrë aktive në bisedat me banorët dhe të edukojnë sipas mënyrë së tyre; • Të ndihmojnë komunën në ndërtimin e materialeve informuese, apo të faqeve të internetit; • Të thithin projekte ndërgjegjësi, përmirësi mjedisor apo turizmi; • Të informojnë komunën dhe aktorët e tjerë mbi problematika të ndryshme dhe të përcjellin filozofinë e tyre për një territor më të shëndetshëm; • Të organizojnë shkëmbime me shkolla të tjera të rajonit; • Të nxjerrin dhe përpilojnë materiale informative si dhe të organizojnë orë të hapura në shkollë dhe komuniteti për të folur mbi risitë e menaxhimit, siç janë refuzimi, reduktimi, ripërdorimi apo riciklimi.
Grupet e interesit (grave)	<ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojnë shëndet të mirë për banorët. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në të gjitha grupet e diskutimeve, takimet apo qoftë dhe direkt në skemën e menaxhimit; • Të marrin pjesë aktive në diskutime dhe takime me aktorët e tjerë; • Të përcjellin problematikën familjare dhe më gjerë në mbështetje të përmirësimit të gjendjes; • Të mundësojnë zbatimin me sukses së skemës së menaxhimit duke edukuar amvisat e të gjithë komunës.
Biznesi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojë largimin e mbetjeve të prodhuara nga shërbimi; • Të sigurojnë shëndet të 	<ul style="list-style-type: none"> • Të marrë pjesë aktive në përcjelljen e problematikës së menaxhimit të mbetjeve; • Të mundësojë ide për reduktimin e mbetjeve dhe alternative të

	mirë për banorët.	<p>grumbullimit të tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të edukojë qytetarët mbi produktet që blejnë, amballazhin, zëvendësimin e qeseve plastike, etj; • Të ndihmojë komunën në zbatimin me sukses të planit të menaxhimit dhe të mundësojë nisma për pastrimin e zonave të ndotura; • Të respektojë me rigozitet të gjitha hallkat e sistemit dhe të sigurojë vetë rrugë të tjera për mbetjet e veçanta si p.sh. vajrat.
Banorët	<ul style="list-style-type: none"> • Të sigurojnë shëndet dhe mjedis të pastër për veten e tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të marrin pjesë aktive në mbështetje të zbatimit me sukses të PMM; • Të veprojnë në mënyrë ndërvepruese, duke lehtësuar edukimin e të gjithë banorëve të komunës; • Të marrin pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë e parashikuara si dhe në ato në natyrë; • Të shpërndajnë informacione dhe dije ndërmjet tyre; • Të paraqesin pranë komunës të gjithë idetë, mendimet dhe shqetësimet për zbatimin me sukses të planit.
Vizitorët dhe emigrantët	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjejnë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të respektojnë rregullat e pastërtisë dhe qytetarisë; • Të sjellin përvojë dhe ide nga vendet nga ku ata vijnë; • Të marrin pjesë në diskutime dhe takime si dhe të komunikojnë me komunën mbi ide dhe shqetësime.

4.5 INDIKATORËT E SUKSESIT

Matja e suksesit të PNEK është e vështirë, pasi të masësh njohuritë dhe rritjen e njohurive nuk është kaq e thjeshtë, përveç nëse angazhohet me shumë burime dhe fonde. Megjithatë, për të parë nëse fushatat janë efektive, disa indikatorë, të cilët do t'i shërbenin përmirësimit të punës për të ardhmen do të ishin:

1. Numri i aktiviteteve të zbatuara gjatë një viti apo një periudhe të caktuar;
2. Pjesëmarrja nëpër takime;
3. Numri i kërkesave, ankesave apo opinioneve të përcjella nga komuniteti;
4. Cilësia e pastërtisë në komunë (nuk ka mbetje jashtë kazanëve, nuk ka vende të reja depozitimi të paligjshme, etj);

5. Numri i çështjeve të trajtuara në shtyp apo media të tjera;
6. Veçanërisht niveli i mbledhjes së tarifës, sidomos në mënyrë "vullnetare" nga banorët dhe grupet e tjera.

Për të bërë të mundur këto vrojtime dhe vlerësime, do të përdoren forma të ndryshme vlerësimi, të tilla si pyetëtori i përdorur gjatë hartimit të këtij plani dhe që gjendet bashkëlidhur këtij plani.

5. SHTOJCAT

Lista e shtojcave

Nr	Titulli
Shtojca 1	Hartat e vendosjes së kazanëve
Shtojca 2	Detyrat e stafit përgjegjës për SMB
Shtojca 3	Itinerari i lëvizjes së makinës
Shtojca 4	Letër sqaruese për anëtarët e këshillit të komunës
Shtojca 5	Tabelat e detajuara të përlogaritjes së kostove
Shtojca 6	Pyetësor për vlerësimin e gjendjes, pritshmërive dhe mundësive për banorët
Shtojca 7	Materiale ndërgjegjësuese për banorët
Shtojca 8	Matricat e vlerësimit të prodhimit të mbetjeve
Shtojca 9	Raporti i takimeve me komunitetin
Shtojca 10	Grupet e interesit
Shtojca 11	Fisha e projektit të ndërhyrjes
Shtojca 12	Foto të zonave problematike

FSHATI **OBLIKË**

Popullsia: **2643 banorë**

Biznese: **25**

Institucione: **8**

Numri mesatar i banorëve për familje: **3,5**

GJENERIMI I MBETJEVE (projektim me mesatarizim):

Banorët: **2643 banorë** x **0,6 kg/ditë** = **1586 kg** ose **1,5 ton**

Biznese: **25** x **10 kg/ditë** = **250 kg** ose **0,25 ton**

Institucione: **8** x **8 kg/ditë** = **64 kg** ose **0,064 ton**

Prodhimi total për fshatin : **1,8 ton**

VENDOSJA E KAZANËVE (total sipas prodhimit):

Prodhimi total për fshatin : **1,8 ton**

Lloji i kazanit: **metalik 1,1 m3**


Kapaciteti mbajtës i kazanit: **0,13 ton**

Nevoja për kazanë për përballimin e prodhimit ditor: **1,8 : 0,13 = 13,8**

Nevoja për kazanë për përballimin e prodhimit 3 ditor: **13,8 x 3 = 41,5**

Sasia e përcaktuar për fshatin: **30 kazanë**

Vendosja: **sipas shtrirjes dhe përqendrimit të prodhimit** ●



FSHATI MURIQAN

Popullsia: **1219 banorë**

Biznese: **17**

Institucione: **4**

Numri mesatar i banorëve për familje: **3,5**



GJENERIMI I MBETJEVE (projektim me mesatarizim):

Banorët: **1219 banorë** x **0.6 kg/ditë** = **731,4 kg** ose **0,8 ton**

Biznese: **17** x **10 kg/ditë** = **170 kg** ose **0,2 ton**

Institucione: **4** x **8 kg/ditë** = **24 kg** ose **0,024 ton**

Prodhimi total për fshatin : **1 ton**

VENDOSJA E KAZANËVE (total sipas prodhimit):

Prodhimi total për fshatin : **1 ton**

Lloji i kazanit: **metalik 1,1 m3 volum**

Kapaciteti mbajtës i kazanit: **0,13 ton**

Nevoja për kazanë për përballimin e prodhimit ditor: **1 : 0,13 = 8**

Nevoja për kazanë për përballimin e prodhimit 3 ditor: **8 x 3 = 24**

Sasia e përcaktuar: **17 kazanë (15 në fshat dhe 2 në kufi)**

Vendosja: **sipas shtrirjes dhe përqendrimit të prodhimit** ●

FSHATI **OBOT**

Popullsia: **688 banorë**

Biznese: **2**

Institucione: **4**

Numri mesatar i banorëve për familje: **3,3**



GJENERIMI I MBETJEVE (projektim me mesatarizim):

Banorët: **688 banorë** x **0,6 kg/ditë** = **412,8 kg** ose **0,4 ton**

Biznese: **2** x **10 kg/ditë** = **20 kg** ose **0,02 ton**

Institucione: **4** x **8 kg/ditë** = **24 kg** ose **0,024 ton**

Prodhimi total për fshatin : **0,4 ton**

VENDOSJA E KAZANËVE (total sipas prodhimit):

Prodhimi total për fshatin : **0,4 ton**

Lloji i kazanit: **metalik 1,1 m3 volum**

Kapaciteti mbajtës i kazanit: **0,13 ton**

Nevoja për kazanë për përballimin e prodhimit ditor: **0,4 : 0,13 = 3**

Nevoja për kazanë për përballimin e prodhimit 3 ditor: **3 x 3 = 6**

Sasia e përcaktuar: **5 kazanë**

Vendosja: **sipas shtrirjes dhe përqendrimit të prodhimit** ●

Përshkrimi i punës për Drejtuesin e Menaxhimit të Mbetjeve

- **Pozicioni i punës:** Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve
- **Përcaktimi:** Përgjegjësi i SMB është personi përgjegjës për mirëfunksionimin e këtij sistemi brenda komunës. Ai do ta kryejë këtë funksion si pjesë integrale të funksioneve të tij të tjera që mund të ketë brenda komunës.
- **Vendndodhja:** I punësuar do të punojë brenda mjedisve të komunës. Kur nevojitet mund të lëvizë në terren për të kontrolluar funksionimin e sistemit.
- **Përgjegjësitë:** Përgjegjësi i SMB gjatë ushtrimit të funksionit të tij do të ketë këto detyra kryesore
 - Menaxhimin e aktiviteteve operacionale duke përfshirë dhe përcaktimin e planeve të punës për të siguruar standardet e përshtatshme të shërbimit duke pasur numrin minimal të personave;
 - Sigurimin e parametrave teknike për blerjet e pajisjeve të reja dhe zëvendësimin e atyre të vjetra;
 - Përgatitjen paraprake të procedurave për punësimin e personave që do të punojnë në SMB;
 - Përgatitjen e raporteve mujore në bazë të të dhënave konkrete mbi ecurinë e mbledhjes së mbetjeve urbane;
 - Përgatitjen e kontratave në rastet e pagesave që kryejnë bizneset private për eliminimin e mbetjeve që ato prodhojnë;
 - Mbajtja e kontakteve ditore me punëtorët që merren me mbledhjen e mbetjeve;
 - Mbajtja e kontakteve të rregullta me autoritetet e pikës së venddepozitimit të mbetjeve (Bushat);
 - Në bashkëpunim me sektorin e financës në komunë monitoron dhe menaxhon shpenzimet dhe të ardhurat si dhe i propozon kryetarit dhe këshillit të komunës buxhetin për vitin pasardhës;
- **Kërkesa për pozicionin:** I punësuar duhet të ketë mbaruar arsimin e lartë (preferohet një degë inxhinierike, apo mjedisore), të ketë njohuri mbi sistemin e menaxhimit të mbetjeve dhe të ketë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike.
- **Të tjera:** Aspekte të tjera të lidhura me punësimin dhe marrëdhëniet kontraktuale rregullohen sipas Kodit të Punës dhe ligjeve të tjera në fuqi.


Përshkrimi i punës për Drejtuesin e Kamionit Teknologjik

- **Pozicioni i punës:** Drejtuesin e Kamionit Teknologjik për mbledhjen e mbetjeve urbane në komunën Ana e Malit
- **Përcaktimi:** Drejtuesi i këtij mjeti është përgjegjës për mbledhjen në të gjitha pikat dhe transportimin e mbetjeve për në venddepozitimin e caktuar nga Komuna Ana e Malit. Kjo detyrë nuk përfshin punësimin me kohë të plotë të personit.
- **Vendndodhja:** I punësuari do të punojë kryesisht brenda fshatrave që janë pjesë e territorit të komunës, por dhe për transportin e mbetjeve për në venddepozitimin e mbetjeve që mund të jenë brenda mjediseve të komunës ose jashtë saj.
- **Përgjegjësitë:** Drejtuesi i mjetit teknologjik për mbledhjen e mbetjeve gjatë ushtrimit të funksionit të tij do të ketë këto detyra kryesore:
 - Drejton pa shkaktuar problem mjetin nëpër të gjitha zonat e caktuara për menaxhimin e mbetjeve;
 - Përdor në mënyrë të sigurtë mekanizmin e ngarkim shkarkimit të kazanëve;
 - Transporton në mënyrë të sigurtë dhe shkarkon mbetjet në venddepozitimin e caktuar nga Komuna
 - Ndhmon punëtorët e mbledhjes së mbetjeve në lëvizjen e kazanëve në rast se këto ndodhen larg vendit ku mund të mbërrijë kamioni;
 - Të jetë i aftë për të përmbushur dhe detyrat që kanë punonjësit e mbledhjes së mbetjeve;
 - Të mbajë në gjendje pune kamionin teknologjik dhe në rast problemesh apo defektesh të lajmërojë pa vonesa përgjegjës të SMB;
 - Të mbajë një tabelë të thjeshtë ku të përshkruhen vëllimet e mbetjeve dhe problematikën e hasur në mbledhjen apo shkarkimin e mbetjeve dhe të raportojë tek përgjegjësi i SMB çdo javë;
- **Kërkesa për pozicionin:** I punësuari duhet të ketë dëshminë e aftësisë për drejtimin e mjetit të kategorisë C (përvoja e mëparshme në këtë lloj aktiviteti përbën përparësi), të ketë kushtet e duhura fizike për të përballuar këtë lloj detyre përfshin dhe ngritjen, lëvizjen apo tërheqjen e peshave të rënda si dhe të ketë aftësi për të punuar në grup. Përveç kësaj, i punësuari duhet të jetë i aftë të punojë në mjedise ku mund të ketë aroma, substance të pakëndshme dhe/ose të dëmshme për shëndetin.
- **Të tjera:** Aspekte të tjera të lidhura me punësimin dhe marrëdhëniet kontraktuale rregullohen sipas Kodit të Punës dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Përshkrimi i punës për Punëtorët e Mbledhjes së Mbetjeve

- **Pozicioni i punës:** Punëtor i mbledhjes së mbetjeve urbane në komunën Ana e Malit
- **Përcaktimi:** Punëtori i mbledhjes së mbetjeve është përgjegjës për mbledhjen e mbetjeve në të gjitha pikat, ngarkimin e tyre për në kamionin teknologjik dhe shkarkimin e tyre në venddepozitimin e caktuar nga Komuna Ana e Malit. Kjo detyrë nuk përfshin punësimin me kohë të plotë të personit.
- **Vendndodhja:** I punësuar do të punojë kryesisht brenda fshatrave që janë pjesë e territorit të komunës, por ngarkimi dhe shkarkimi i mbetjeve për në venddepozitimin e mbetjeve mund të kërkojë lëvizjen e tij dhe jashtë territorit të komunës.
- **Përgjegjësitë:** Punëtori i mbledhjes së mbetjeve gjatë ushtrimit të funksionit të tij do të ketë këto detyra kryesore:
 - Ngarkon kazanët e mbledhjes së plehrave në mekanizmin ngarkues që ndodhet në pjesën e mbrapme të kamionit teknologjik;
 - Përdor në mënyrë të sigurtë mekanizmin e ngarkim shkarkimit të kazanëve;
 - Shkarkon kazanët e mbetjeve në kamion dhe i kthen në pozicionin e tyre fillestar;
 - Pastron territorin përreth kazanëve nga mbetjet që mund të jenë derdhur aksidentalisht jashtë kazanëve dhe i ngarkon ato në kamion;
 - Dezinjekton rregullisht kazanët dhe territorin përreth tyre;
 - Ndhmon në shkarkimin kamionit teknologjik në venddepozitimin e caktuar nga komuna;
 - Mirëmban kazanët dhe kur është e mundur kryen riparime të vogla të tyre për t'i mbajtur në gjendje pune;
- **Kërkesa për pozicionin:** I punësuar duhet të ketë kryer arsimin 8-vjeçar (eksperienca në punë të ngjashme përbën përparësi) kushtet e duhura fizike për të përballuar këtë lloj detyre përfshin dhe ngritjen, lëvizjen apo tërheqjen e peshave të rënda si dhe të ketë aftësi për të punuar në grup. Përveç kësaj, i punësuar duhet të jetë i aftë të punojë në mjedise ku mund të ketë aroma, substance të pakëndshme dhe/ose të dëmshme për shëndetin.
- **Të tjera:** Aspekte të tjera të lidhura me punësimin dhe marrëdhëniet kontraktuale rregullohen sipas Kodit të Punës dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Itinerari i lëvizjes së makinës (Komuna Ana e Malit)



Shpjegimi

Niset nga Komuna, drejt në Doganë (6,5 km), pa ngarkuar. Fillon ngarkimin tek bizneset në doganë dhe kthehet duke ngarkuar në Shtuf (1,7 km). Kthehet mbrapsh dhe vijon grumbullimin gjate fshatit Muriqan, dhe vjen në kryqëzimin e Obotit. Shkon në Obot (8 km) dhe kthehet mbrapsh në të njëjtën kthesë. Vijon lart për në Alimetaj (7,5 km) dhe kthehet mbrapsh e futet në Velinaj. Kthehet mbrapsh dhe vjen në Oblikë (7 km). Futet nëpër fshat duke mbledhur pikat e ndryshme gjatë përroit, gjatë rrugës, mbi dhe nën të (8 km). Më pas largohet ngarkuar për në Bushat (17 km).

Totali i lëvizjes **55,7 km**

Drejtuar:

Komunës Ana e Malit / Këshillit Komunal
Komuna Ana e Malit / Shkodër

Datë 13 Prill 2011
Nr. Prot _____

Nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Tiranë

Lënda: Relacion për Këshillin Komunal të Komunës Ana e Malit,

I/E nderuar përfaqësues/e

Ju lutem gjeni më poshtë për konsiderimin dhe miratimin nga ana juaj të skemës, buxhetit dhe tarifave vendore për të vendosur për herë të parë dhe në funksionim të plotë sistemin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve për Komunën Ana e Malit.

1. Projekti dhe ndërhyrja

Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Komunën Ana e Malit vjen si kërkesë e Komunës Ana e Malit drejtuar IC/dldp (programit të decentralizimit dhe zhvillimit vendor) dhe po përgatitet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri në bashkëpunim me stafin e komunës, nëpërmjet një procesi me përfshirje të gjerë të komunitetit. Ky projekt do të zbatohet për periudhën Mars – Qershor 2011 dhe ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mjedisit në komunën Ana e Malit dhe ka tre objektiva specifike, të cilët janë:

- Hartimi planit të menaxhimit të mbetjeve për komunën Ana e Malit
- Forcimi i infrastrukturës së mbetjeve për komunën Ana e Malit
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të banorëve të zonës në zbatimin e një plani menaxhimi eficient

si dhe

- Mbështetje në ngritje kapacitetesh të njësive vendore pranë komunës së Anës së Malit, për nxitjen e marrjes së nismave të ngjashme në të ardhmen.

Më specifikisht plani do të përpiket të:

- Ndërtojë një përputhje me qëllimet dhe synimet kombëtare për menaxhimin e mbetjeve si dhe harmonizim të përpjekjeve rajonale në menaxhimin e mjedisit në përgjithësi. Miratimi së fundmi i Strategjisë së Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, mundëson një kuptim më të drejtë dhe të qartë të synimeve të këtij sektori. Kështu, vetë plani i komunës së Anës së Malit do të ndjekë në maksimumin realist këtë zhvillim;
- Përcaktojë rrymat e mbetjeve dhe mundësisht sasinë e mbetjeve të gjeneruara në komunë, gjë e cila do të mundësojë një kuptim më të drejtë të masave dhe ndërhyrjeve që do të mund të vihen në veprim;

- Përcaktojë mënyrën më efektive të menaxhimit të mbetjeve në këtë komunë, bazuar në mundësitë dhe nevojat që kanë zona të ndryshme të komunës për ndërhyrje.
- Përcaktojë kërkesat ekonomiko-financiare, të cilat do të mund të përcaktojnë tarifën dhe buxhetin e duhur për të ngritur një skemë realiste me afate kohore të qarta, në zhvillimin e sistemit drejt qëndrueshmërisë.

Gjithashtu:

- Do të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit rajonal në hartimin e skemës së menaxhimit;
- Do të ofrojë mundësi të shkëmbimit të njohurive gjatë procesit të punës dhe përvojës së fituar me njësi të tjera pranë Komunës Ana e Malit, në varësi të shprehjes së tyre të interesit, për të vijuar me nisma të tilla në të ardhmen.

2. Skema e grumbullimit dhe transportimit

Stafi teknik i projektit ka vlerësuar skemën e vetme të ndërhyrjes, e cila konsiston në fuqizimin e sistemit në parametrat e kohës, duke vendosur kanazë metalikë 1.1 m³ dhe një makinë 7-8 tonëshe për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Për të përmbushur më mirë nevojat që ka komuna për një mjedis më të pastër është rënë dakort që mbetjet pasi të grumbullohen të dërgohen në fushën e mbetjeve në Bushat, kundrejt një pagese për depozitim prej 7 euro për ton.

Duke marrë parasysh mundësitë aktuale për investim dhe mbulim nevojash, është bërë një ndarje e ndërhyrjes sipas tre skemave, të cilat shpjegohen në vazhdim.

Vendosja e një sistemi të plotë për komunën kërkon vendosjen e rreth 150 kazanëve metalikë, një makinë për grumbullimin, me një lëvizje të saj një herë në 3 ditë dhe punësimin e tre punonjësve me kohë të pjesëshme. Ky sistem është përlogaritur sipas një skeme e quajtur **skema 1 dhe ka si kosto totale zbatimi 8.000.000 leke të reja dhe kosto operacionale vjetore 3.500.000 leke të reja**. Ndërkohë që **skema 2**, heq banorët, të cilët nuk jetojnë në mënyrë aktive në komunë dhe kjo shifër është rreth 900 banorë më pak. Kostoja për zbatimin e kësaj skemë është **8.000.000 lekë të reja dhe kostot operacionale vjetore 3.200.000 lekë të reja**.

Skema e tretë, e cila është parashikuar të zbatohet në këtë fazë, ka marrë në konsideratë mundësitë financiare dhe nevojat më të ngutshme për ndërhyrje. Kështu, kjo skemë do të kërkojë vendosjen e 50 kazanëve metalikë 1.1m³ në fshatara Oblikë, Muriqan dhe Obot, do të mundësojë blerjen e një makine për transportimin e mbetjeve në Bushat dhe do të kërkojë punësimin me kohë të pjesëshme të tre punonjësve (2 punëtorë dhe një shofer). Kostot për vendosjen e kësaj skeme janë 4.900.000 lekë të reja dhe ato operacionale vjetore 2.700.000 lekë të reja, e cila mund të jetë dhe më e vogël në varësi të sasisë reale të mbetjes së grumbulluar dhe depozituar në Bushat.

Mbullimi i investimit është parashikuar të bëhet me fondet e IC/dldp, (programi për decentralizimin dhe zhvillimin lokal) në vlerën 24.960 Euro ose 3.495.000 lekë të reja. Pjesa tjetër e fondit duhet të bashkëfinancohet në vlerën 9490 Euro ose 1.320.000 lekë të reja nga Komuna Ana e Malit, në mënyrë që të përfitohet fondi nga IC dhe të vihet në zbatim skema.

Vendosja e kësaj skeme do të kërkojë mbulimin e kostove operacione dhe më vonë zgjerimin e skemës në të gjithë komunën. Për këtë prodhuesit e mbetjeve, familjarët, bizneset dhe institucionet do të duhet të paguajnë tarifën e mbetjeve, e cila është përcaktuar dhe jepet për diskutim dhe miratim nga ana juaj në pikën 4 të këtij relacioni.

3. Përlllogaritja e kostove

3. Llogaritja e kostove (Oblikë, Murriqan, Obot)					
		Njësia	Numri	Çmimi	Vlera
Grumbullimi					
	Konteinerë	Copë	50	30,800	1,540,000
	Mirëmbajtje konteinerësh (7% në vit)				107,800
	Lopata, fshesa etj.	Copë	8	500	4,000
	Veshmbathje pune	Copë	2	5,000	10,000
	Materiali dezinfektues (36 kg/vit për kazan)	kg	1,800	10	18,000
Transporti					
	Kamion teknologjik	Copë	1	3,360,000	3,360,000
	Mirëmbajtje e mjetit (7% në vit)				235,200
	Amortizimi i mjetit (5% në vit)				168,000
	Karburant (sipas tabelës së mëposhtëme)	litra	3,380	165	557,700
Depozitimi					
	Depozitimi në landfillin e Bushatit	Ton	1,054	980	1,033,216
Staf					
	Shofer (20 orë në javë)	Orë pune	1,040	190	197,600
	Punëtorë (2 nga 24 ore secili në javë)	Orë pune	2,496	130	324,480

Përsa më sipër, kosotot llogariten:

Kosto totale e investimit: 7,555,996 lekë të reja

Kosto fillestare: 4,900,000 lekë (e financuar nga IC/dldp me bashkëfinancim nga komuna)

Kosto operative: 2,655,996 lekë (kosto vjetore, të cilat do të rishikohen me zbatimin në praktikë dhe me shtrirjen e mëtejshme të sistemit)

4. Vendosja e tarifave

Gjatë llogaritjeve janë mbajtur parasysh që 70 përqind e shpenzimeve i përballojnë familjet, 28 përqind bizneset dhe 2 përqind institucionet

Gjatë katër viteve, Komuna do të subvencionojë kostot 20 % për dy vitet e para dhe 10 % për dy vitet e dyta. Më pas e gjithë kosto e menaxhimit të mbetjeve do të duhet të përballohet nga familjet, biznesi dhe institucionet.

Kostot operative për pesë vitet e ardhshme janë llogaritur si mëposhtë:

Skema 3	Kontributi në sistemin e menaxhimit të mbetjeve (në %)	80	80	90	90	100
		2011	2012	2013	2014	2015
	Pesha specifike që mbulon çdo kategori (në %)					
Familjet	70	1.077	1.098	1.260	1.285	1.457
Bizneset	28	12.643	12.895	14.797	15.093	17.106
Institucionet	2	1.806	1.842	2.114	2.156	2.444
Komuna	Subvencion	541.823	552.660	281.856	287.494	0

Ky relacion përcakton në mënyrë të përmblodhur por të plotë elementët e kësaj ndërhyrje. Duke marrë parasysh nevojat e mundshme për sqarime dhe diskutime më të hollësishme, stafi i projektit është në dispozicion të këshillit sipas kërkesës së tij paraprake.

Mihallaq Qirjo

Drejtor i REC Shqipëri

Drejtues i projektit dhe ekipit për hartimin e planit

Annex 5

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri i fshatit

		Komuna	Oblikë	Muriqan	Obot	Velinaj	Alimetaj	Shtuf
1	Numri i banorëve	5854	2643	1219	688	347	941 ?	196
2	Numri i shtëpive/ banesave	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
